

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7709 E mërkurë 14 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Më 4 mars 1929, 89 vjet më parë, një burrë i veshur shik, me pamje krejt perëndimore dhe me ecje që binte në sy në një qytet ende oriental si Tirana ...  
Vijon në faqen 20

Nga BLENDI FEVZIU

E vërteta vonon,  
por nuk harron!



Opinion **i** Ditës

Në të njëjtën ditë që Rama përmbysi shqiponjën "korb" në hyrje të Tiranës, Macron në Paris fliste për nacionalizmin që tradhton patriotizmin. Sigurisht ...  
Vijon në faqen 21

Nga KOÇO KOKËDHIMA

Tradhtia e patriotizmit



Digjen goma dhe flamuri i Rilindjes

## Tym dhe flakë tek Unaza e Re, banorët në protestë: Nuk jemi shpellarë, po qytetarë

Veliq: Nuk tërhiqemi nga projekti, PD-ja po nxit mitingashë me qira. Përgjigjja: Po silleni si serbët

VALENTINA MADANI

Banorët e zonës së "Astirit", të cilëve do t'u shemben banesat nga ndërtimi i Unazës së Madhe tentuan dje të hynin me forcë në Bashkinë e kryeqytetit. Për më shumë se një orë kërkuan prej kryebashkiakut Erion Veliq ...  
Në faqen 4-5

## DEMSHPERBLIMI, DOKUMENTET QE MUNGOJNE NE DOSJET E SECILIT APLIKANT

# ISH-TE PERNDJEKURIT, 5700 EMRAT QE DO KOMPENSOHEN

Pjesa e katërt/ Ministria e Financave publikon trashëgimtarët që përfitojnë fondin financiar. 3 muaj afat për plotësimin e dokumenteve



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

**KRYEMINISTRI**

**Rama: Kam besim se Presidenti Meta do ta dekretojë ministrin Lleshi**

Në faqen 2

**PENSIONI I INVALIDITETIT**

**Kempi, emrat e 284 personave që do të kryejnë kontrollin mjekësor**

Në faqen 9

**ISH-KRYEMINISTRI**

**Frika nga arresti, Nikolla Gruevski kërkon strehim politik në Hungari**

Në faqen 17

**KULTURE**

**Nis sot panairi i librit, Ymeri: Në fokus, leximi pas rënies drastike**

Në faqen 18

**BEFASIA NE GJYQ**



**Grupi i Shijakut, Astrit Avdyli: Dakon e kam mik, aty i qaj hallet**

Në faqen 10

Gjykata e Krimeve të Rënda jep vendimin, rrëzohet akuzat për shkatërrim prone

## Gjobë biznesmenit, 14 vjet burg Shullazit

Grupi dënohet 55 vjet në total. Bie akuzat për kërcënim të rektorit të UT

**T**IRANË- Pas afro 50 seancash gjyqësore ka marrë fund saga "Shullazi" në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Në seancën e zhvilluar ditën e djeshme, kjo gjykatë ka dënuar me 14 vjet burg "kokën" e këtij grupi kriminal, Emiljano Shullazi. Ky i fundit u shpall fajtor për akuzat e gjobëvënies



dhe krijimit të grupi të strukturuar kriminal, ndërsa u shpall i pafajshëm për akuzën e presionit dhe kanosjes ndaj dy rektorëve Mynyr Koni e Dhori Kule dhe atë të shkatërrimit të pronës, për vendosje tritolli biznesmenit Jani Zaka në Tiranë dhe Adriatik Kuçuku ...  
Në faqen 6

## KRIZA DEKRETI

Kryeministri u shpreh se presidenti nuk ka arsye që ta refuzojë Lleshin

# Rama: Uroj që Meta të mos jetë nën influencën e opozitës

*"Ndeshja me kanabisin ka mbaruar përfundimisht"*

Pavarësisht aktit të Sandër Lleshit për t'u tërhequr nga e drejta për të qenë ushtarak aktiv, kryeministri Edi Rama është i bindur se propozimi i tij edhe herën e parë edhe tani ka qenë plotësisht ligjor. Duke folur në emisionin "Repolitix" ai u shpreh se propozimi është kushtetues dhe se statusit i tij i ushtarakut nuk ishte aktiv. "Unë s'kam shkelur asnjë Kushtetutë dhe s'kam pas as si ta shkel. Edhe sikur të ishte Sandër Lleshi gjeneral i Forcave të Armatosura unë mund ta propozoja dhe sigurisht presidenti mund ta dekretonte si ministër. Së dyti, Sandër Lleshi nuk është gjeneral aktiv. Ishte ende në gjyq me Ministrinë e Mbrojtjes. Për çfarë është në gjyq Sandër Lleshi me Ministrinë e Mbrojtjes nëse është gjeneral aktiv? Kthimi në punë i një gjenerali nuk bëhet nga gjykata. Propozimi është kushtetues", tha Rama. Më tej ai u shpreh se gjatë bisedës që kishte pasur me presidentin, ky i fundit nuk i kishte shprehur asnjë shqetësim që ka të bëjë me statusin e tij të ushtarakut aktiv. "Presidenti nuk ka shprehur një shqetësim të tillë, sepse nëse do ishte shprehur do kishte gjetur zgjidhje. Kishte 7 ditë kohë. Çfarë bëri presidenti në këto 7 ditë? Nuk tha asgjë të tillë. Sot janë kushtet që ta zgjidhim. Presidenti ka detyrë të dekretojë ministrat dhe kryeministrin në rast se këta plotësojnë kriteret për t'u zgjedhur deputet", u shpreh më tej Rama. Pyetjes së të ftuarve nëse ishte gati që të ulej me Metën dhe Ruçin për të diskutuar dhe për t'i dhënë zgjidhje këtij ngërçi, Rama iu përgjigj "S'ka nevojë fare për takime të kësaj natyre".

**META**  
Në kohë që lidhur me arsyet e kësaj sjellje të Presidentit Meta ai është shprehur se nuk do të donte që ai me pozicionin që ka marrë në këtë debat t'i shërbejë opozitës. "Unë uroj shumë që presidenti të ketë realist shqetësimin që ka shprehur dhe të mos jetë viktimë e trazirës psikologjike dhe morale të opozitës që mund të ketë influencën mbi të që të luaj një rol destruktiv. Për sa kohë s'kam asnjë argument për të mbrojtur këtë unë mendoj që presidenti nuk ka asnjë arsye që të mos dekretojë ministrat të Brendshëm, Sandër Lleshin", deklaroi Rama.

**XHAFAJ**  
Rama ka mbrojtur edhe ish-ministrin e tij të Brend-



Kryeministri Edi Rama, dje në emisionin "Repolitix"

shëm, Fatmir Xhafaj, duke theksuar se nuk ka pasur asnjë kërkesë apo presionin për dorëheqjen e tij. "S'ka asnjë diskutim se s'kam pasur asnjë arsye. Ka dhënë

dorëheqjen me vullnetin e tij të lirë dhe do ketë respektin tim në punën që ka bërë", tha kryeministri. Ndërsa pretendimet e të ftuarve në studio se ai nuk fliste me

**DORËHEQJA**  
"S'ka asnjë diskutim se s'kam pasur asnjë arsye. Ka dhënë dorëheqjen me vullnetin e tij të lirë dhe do ketë respektin tim në punën që ka bërë", -tha kryeministri. Ndërsa pretendimet e të ftuarve në studio se ai nuk fliste me Xhafaj, Rama iu përgjigj: "Kjo është gënjeshtër, nuk është e vërtetë".

Xhafaj, Rama iu përgjigj: "Kjo është gënjeshtër, nuk është e vërtetë". Duke folur për çështjen "Tahiri" ai deklaroi se tashmë që drejtësia italiane është shprehur të

gjithë ata që e akuzuan dhe folën gjatë këtij viti, duhet të kërkojnë falje. Sa i përket situatës së kanabisit, kryeministri e ka konsideruar atë një luftë të fituar nga policia. "E di si më dukesh, si ata gazetarët sportiv që i drejtohen trajnerit që pse nuk fute këtë lojtar. Unë them kam fituar ndeshjen, ti më thua pse pësove gol në pjesë të parë. Ndeshja me kanabisin ka mbaruar. Është e qartë dhe është përfundimtare", nënvizoi Rama. Kreu i qeverisë u shpreh se zgjedhjet e ardhshme lokale do të mbahen në datën 30 qershor pavarësisht nëse opozita do të marrë pjesë në to ose jo. Rama nuk ka pranuar të shprehë nëse në këto zgjedhje do të rikandidojë disa nga kryetarët aktual të bashkive më të rëndësishme në vend, duke theksuar se këtë do e vendosë PS.



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama



**Hyn në fuqi ligji për "Teatrin", gati ngritja e komisionit**

Ka hyrë sot në fuqi ligji që do mundësojë prishjen e godinës aktuale të Teatrit Kombëtar dhe ngritjes së një godine të re. Kjo pasi ligji që u miratua nga Kuvendi ka mbushur 15 ditë nga momenti i botimit në Fletoren Zyrtare, çka do të thotë që tashmë ai ka hyrë në fuqi dhe mund të japë efekte konkrete sa i përket fatit të teatrit. Me hyrjen në fuqi të ligjit, duhet të ngrihet komisioni nga Këshilli i Ministrave, i cili kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Bashkia e Tiranës dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve të ndryshme përfshi edhe dy përfaqësues të trupës së aktorëve. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë propozimet e paraqitura nga qdo palë e interesuar për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtime dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**"Ky është një kërcënim për zhvillimin tonë ekonomik"**

## Meta: Shqipëria duhet të bëjë më shumë që të rinjtë të mos largohen



shumë larg për sa i takon potencialit tonë të mundshëm në industrinë detare dhe të turizmit. Kjo është arsyeja pse e përcaktuar me përparësi këtë sektor

strategjik, duke pasur parasysh, gjithashtu, ofrimin e një risie të re ende të pa eksploruar, të pajisur me perspektivë për zhvillim të mëtejshëm", tha Meta. Ai shtoi se

është shumë e rëndësishme, edhe për Shqipërinë që të përballë me fenomenin e largimit të rinjve duke i ofruar atyre më shumë mundësi për të qëndruar në vend. "Ky është një kërcënim i drejtpërdrejt për zhvillimin tonë ekonomik dhe kohezionin social. Nëse nuk trajtohet në shkaqet dhe rrënjët e tij, ai mund të prodhojë një cikël të rrezikshëm vicioz që vështirë se mund të shpërthehet e të këputet. Prandaj unë konsideroj se nuk ka gjë më të rëndësishme se mbajtja e të rinjve tanë të mbushur plot shpresa dhe të motivuar për të jetuar dhe punuar në Shqipëri", tha Meta.



Ministri i Financave propozoi tatimin e pagave deri në 100 mijë lekë

# Propozimi i qeverisë, Braçe: Nuk i taksojmë pagat nën 30 mijë lekë

"Pagat e vogla dhe ato të mesme duhet të mbrohen"

Pas 5 vitesh në pushtet, socialistët kanë qënë drime të ndryshme sa i përket një prej vendimeve më të rëndësishme që morën në 2013-ën dhe që ka të bëjë me tatimin progresiv. Ndërsa nuk kanë hequr dorë plotësisht prej saj, këtë vit bashkë me diskutimin e buxhetit dhe paketës fiskale, kanë rihapur debatin nëse duhet të preket dyshemeja e tatushme apo jo. Përkundër propozimit të një grupi deputetësh socialistë për të rritur këtë dysheme nga 30 në 40 mijë lekë të ardhura, ministri i Financave, Arben Ahmetaj bëri të ditur dje se do i kërkonte zyrtarisht Kuvendit që kjo dysheme jo vetëm që nuk duhet të rritet në 40 mijë lekë, por përkundrazi ose duhet të zbrësë në tatimin e të ardhurave mbi 10 mijë lekë, ose të përfshihen në këtë skemë të gjitha të ardhurat e çfarëdo lloji niveli. Por me këtë propozim që shkon totalisht kundër propozimit të deputetëve socialistë, ka reaguar dje edhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe.



Kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe

**PAGAT**  
"Unë e sfidoj ministrin ta sjellë këtë propozim në rast se e ka seriozisht që të propozojë të taksojë pagat nën 30 mijë lekë. Ky vend, në kushtet në të cilët ndodhet, pra në kushtet kur kemi nevojë për punën, në kushtet kur ne kemi edhe nën faktin e migracionit, unë mendoj se pagat e vogla, por jo vetëm, edhe ato të mesme duhet të mbrohen".



**Rama: Kemi dyfishuar mbështetjen për bujqësinë**

Kryeministri Edi Rama mori pjesë dje në prezantimin e buxhetit 2019 sa i përket fushës së bujqësisë. Gjatë një takimi në fshatin Ibbë të Tiranës, ai tha se që kur PS mori qeverinë në dorë janë dyfishuar eksportet bujqësore dhe se për herë të parë këtë vit importet ushqimore nuk janë rritur. "Kur ne filluam punën, ne kemi dyfishuar eksportet bujqësore. Është një shifër që flet qartë për ata cinikët që nuk e dinë fare se ç'është hapësira e fshatit shqiptar. Për herë të parë këtë vit, importet ushqimore nuk janë rritur. Së dyti, vitin që vjen do të kemi një buxhet në mbështetje të bujqësisë, që është më shumë se sa vitet e qeverisë së mëparshme të marrë së bashku", tha Rama. Ai theksoi se edhe vitin e ardhshëm do të vijojë të implementohet programi i ri i mbështetjes për fermerët me vlerë 20 milionë euro. "Kemi realizuar një lehtësim shumë të konsiderueshëm të procesit të aplikimeve, duke kaluar në 0 dokumente për të gjithë ata që duan të përfitojnë nga skemat mbështetëse dhe duke i kërkuar dokumentet, pasi propozimi shpallet fitues", tha Rama.



**Mesi pret BE-në: Aftësim dixhital për të rinjtë**

Zëvendëskryeministri Mesi priti dje në një takim komisionerëve evropianë për Ekonominë Digjitale dhe Shqipërisë dhe progresi i bërë deri tani, siguria kibernetike, marrëveshja e re për uljen e tarifave "roaming" ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe digitalizimi i shërbimeve publike. Gjatë këtij takimi, Mesi u shpreh se Shqipëria po ecën përpara drejt shqërsisë dhe ekonomisë digjitale, duke krijuar mundësi të reja për qytetarët dhe bizneset për të përfutur nga teknologjitë e reja dhe inovacioni. "Një ndër elementët kryesorë për të cilët po punojmë dhe jemi në një linjë edhe me përfaqesat rajonale dhe evropiane është edhe aftësimi digjital i të rinjve", shtoi ajo, duke nënvizuar përparësinë që i jep qeveria shqiptare promovimit të nisave digjitale si një instrument thelbësor për modernizimin e qeverisjes dhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik për qytetarët e saj.

Ministri u shpreh se do ketë rritje për edukatorët me 9%

## Ahmetaj: Rritja e pagave për çdo kategori, 20% për diplomatët

Diplomatët do të përfitojnë rritjen më të madhe të pagave vitin e ardhshëm nga të 4 kategoritë që në 2019 të përfitojnë do të pësojnë rritje të pagës. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj ka detajuar rritjen që përfiton secila prej këtyre kategorive, duke bërë të ditur se diplomatët do të përfitojnë një shtesë page prej 20 për qindësh. Më pas vijjnë ushtarakët, por jo me kufij minimalë prej 19 për qind, siç deklaroi kryeministri. Ahmetaj bëri të ditur se rritja për mbrojtjen do të nisë nga 10 për qind, ndërsa 19 për qind është kufiri maksimal i rritjes dhe që do të përfitojnë ushtarakët më të ulët në gradë. Një ulje më të vogël do të përfitojnë edhe dy kategori shumë të mëdha punonjësish, siç janë arsimtarët dhe ata që punojnë në shëndësi. Të dyja këto kategori do të kenë një rritje prej 7 për qind, kjo pasi ata zënë edhe një peshe më të madhe



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

në masën e pagave shtetërore. "Duan që të projektojmë një rritje pagash në shëndësi, rritje kjo prej 7%. Gjithashtu, në rritje prej 7% planifikohet edhe në arsim. Ndërsa mbrojtja do të përfitojë një rritje nga 10-19% dhe një rritje prej 20% për diplomatët", tha Ahmetaj. Kreu i Financave theksoi se fondet për pagat e edukatoreve do të rriten me 9.1% në raport me 2018 dhe ndarja e fondeve për çdo bashki, do bëhet me një formulë që mbështetet kryesisht në numrin e nxënësve përfutues. Ndërkohë që ai bëri të ditur se i gjithë zëri i pagave në buxhetin e ardhshëm ka rritje në vlerë totale. "Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën 80.6 miliardë lekë ose 4.6% e PBB", tha Ahmetaj. Kjo, jo vetëm për shkak të rritjes së pagave për kategoritë e mësipërme, por edhe për shkak të reflektimit në buxhet të pagave dhe shpenzimeve që vijnë nga aplikimi i reformës në drejtësi.

propozimit jo vetëm timit, por edhe të disa kolegëve që mbronin për një dysheme të re për të mbrojtur punën, sepse këto janë të ardhura nga puna. Kur të bëhet diskutimi nën parë nën për propozimin

do të mbaj këtë qëndrim", - theksoi Braçe. Aktualisht numri i të punësuarve me pagë të deklaruar deri në 30 mijë lekë arrin në 388 mijë. Nëse merret në konsideratë shkalla më e ulët e propo-

zuar nga ministri i Financave për një taksim prej 1,5% të pagës, çdo i punësuar do të duhet të paguajë nga 360 lekë deri në 450 lekë më shumë në muaj si tatim mbi të ardhurat personale.





Reagimi, Strazimiri: Kur zbritët nga shpella në '44, vratë ajkën e Tiranës

# Unaza e Madhe, Veliaj: Nuk tërhiqemi nga projekti

"PD nxit protestat, e njëjta parti me stil shpellar"

Valentina Madani

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, u premtoi dje banorëve që preken nga ndërtimi projekti i Unazës së Madhe se do të dëmshpërblehen për çdo qindarkë, ndërsa u bëri thirrje që të mos përdoren si mish për top nga PD-ja dhe Lulzim Basha. Pas ikjes së protestuesve para godinës së bashkisë, kryebashkiaku Erion Veliaj doli para media-ve, ku akuzoi Partinë Demokratike se po nxit banorët kundër një projekti që e ka firmosur vetë Lulzim Basha kur ishte kryetar Bashkie. "Dëgjoj sot njerëz që unë e di ku e kanë shtëpinë, s'janë fare aty. Mitingashë që mermen me qira për çfarëdolloj mitingu. Po Luli është një kalama i llastuar, pse me atë do merremi ne? Ai e kishte mundësi që ta bënte edhe autostradën. Thirrja ime për gjithë banorët që po përdoren padrejtësisht, që po përdoren mish për top dhe vijnë të bashkia kur s'ka lidhje fare bashkia. Bashkia është vetëm t'ju ndihmojë kush do dorën e bashkisë", deklaroi Erion Veliaj. Ai garantoj se banorët me dokumente pronësie do të dëmshpërblehen, ndërsa familjet e tjera do të trajtohen nga programet sociale. "Kemi ofruar si bashki e Tiranës 3 vite qira, për ata që s'kanë asnjë letër, ta themi troç, që kanë zaptuar tokën e dikujt tjetër, jo tokën e tyre. Erdhën në Tiranë dhe zaptuan tokën e dikujt, në gurmën e Unazës. Ka qenë 2 vite, ne do e bëjmë 3. Dihej që në kohën e Adil Çarçanit, shumë prej juve keni lindur pas Adil Çarçanit, nuk e dini fare për kë po flas, por që në kohën e tij këtu kalon rruga, këtu është bulevardi, këtu është Lana, këtu është Liqeni. Ishin po të njëjtët njerëz", u shpreh z.Veliaj. Ai akuzoi kryetarin e PD, Lulzim Basha se po shet kauzat e opozitës në këmbim të lekëve të marra apo favoreve të tjera për kumatin e tij. Veliaj theksoi se PD dhe Basha janë kthyer në një agjenci



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj

**ERION VELIAJ**


"Fatmirësisht shumica e qytetarëve duan që Unaza të bëhet. Mjafton të pyesni qytetarët që janë sot te Bulevardi i Ri dhe të shikoni çfarë mrekullie ka dalë bulevardi i ri për qytetin dhe si po zhvillohet Tirana aty. Ishte po e njëjta parti me këtë stilin shpellar, dhuno, prish, blloko, jo po s'duam, jo po mos e prek", tha kreu i bashkisë.

**GENT STRAZIMIRI**

"Kur zbritën nga shpella me opinga e poture në nëntor 1944, vranë në pragun e derës ajkën e Tiranës, nxorën nga shtëpitë shekullore pronarët e ligjshëm dhe u futën vetë brenda me gjithë morrat që kishin në trup, grabitën për 46 vjet rresht çdo pëllëmbë toke që nuk u kallonte për të ndërtuar pallate për oficerët e Sigurimit dhe nuk quheshkan zaptues...", - tha Strazimiri.

## Unaza e Re, Zhupa: Rama e Veliaj po sillen si serbi me kosovarët

Zëdhënësja e PD-së, Ina Zhupa foli dje në "News 24" për projektin e Unazës së Re, sipas së cilës kompanitë që janë zgjedhur si fituese të projektit kanë probleme të mëdha ligjore. Duke u ndalur tek tenderi dhe kompanitë, Zhupa theksoi se: "40 milionë euro janë dhënë për me pak se 3 km rrugë. 'Vëllezërit Hysa' janë 3 herë në tender pa ofertë. Janë tri kompani, 'Biba X Dh Albania', Salilari dhe Viktori Invest. 'Biba X' është nën sekuestro kur u zhvillua tenderi. Në 3 tendera, vetëm një ofertues i vlefshëm. I kanë dhënë 18 mln euro pronarëve 'off-shore' të panjohur", tha Zhupa. Gjithashtu, ajo deklaroi se PD-ja nuk është kundër ndërimit të Unazës së Re,



por sipas saj, ajo që shqetëson PD-në është fakti se banorët nuk po trajtohen siç duhet. "Kjo është firma që ka marrë pjesën e Luanit. Janë tre tendera fiktive dhe të paracaktuara. Kjo është afëra korruptiveve tek Unaza e Re. Unë pres që prokuroria të hetojë dhe të

vërë para ligjit shkelësit. E para është mbështetja në këto kushte. Mbështetja ka qenë prezente. Dënoncimi e kësaj afere që të shikohet edhe një herë projekti dhe të shikohet se kush është zgjidhja. Banorët nuk do të pranojnë që do të largohen nga shtëpitë në mënyrë aq të lehtë. PD do t'i mbështesë. Në çdo vend normal shpërblehesh dhe ikë në jetën tënde. Ata banorë nuk kanë vetëm shtëpinë, por edhe bizneset e tyre. Projekti i Unazës është i rëndësishëm. Nuk jemi kundër saj, por jemi kundër si po trajtohen banorët. Ne do mëshojmë që projekti të bëhet, por të shpronësohen sipas çmimit të tregut. Brenda një shtëpi jetojnë minimalisht 4-5 familje", - tha zj.Zhupa.



## Balliu, Veliaj: Ti dhe raca jote e barbarëve do të mbani përgjegjësi

Deputeti i PD, Klevis Balliu bën përgjegjës kryeministrin Rama dhe kreun e bashkisë, të afërës korruptive sikundër e konsideron PD projektin për Unazën e Madhe. "Flet për një projekt të fituar me tender fiktiv, pasi kompania e dytë kishe ofruar 0 lek që të fitonte një kompani 'offshore'. Ti more Lali Kulla, që pagove me kulla djalit e Xhaxhajt të Fushës që të shpëtoj nga burgu. Ti na tregon Europën! Por në cilin vend European paguhen taksa dhe të prishen shtëpitë pa kompensim? Në cilin vend European ke të drejtë vote kur je ilegal, siç i quan ti këto familje që kanë 20 vite aty? Ti je pasqyra e vërtetë e kësaj qeverie, pasi je ndërthurja e mashtrimit me hipokrizinë. Barbarizmi yt dhe i qeverisë tënde ndaj familjeve shqiptare është i paparë dhe dëgjuar në Europë. Por ti nuk e kupton çfarë është Europa. Ti pandeh se Europa janë rrugët e bukura dhe nuk kupton që Europa është Europë sepse ka demokraci, sepse qytetarët kanë të drejtat e tyre, që ka zgjedhje të lira e të ndershme, që ka ligj e ka shtet. Por ti dhe raca jote e barbarëve do të mbani përgjegjësi. Pandeh ti se jeta është katër vite në bashki! Sa gabim je more Erioni i Griseldës, frikacak bashkisë".

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 8 / 58 + 1 - 4 , e llojit 'Apartament', volumi 3 , faqe 188, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 75 m2, në bashkëpronësi të ENGJELL LUAN TOPORE dhe NATASHA LUMAN TOPORE , me adresë: Rruga "Thi Ziko", Pallati 65 / 3, Tiranë.

ÇMIMI 36.350 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 101 / 8, "Trull + Ndërtësë", ndodhur në zonën kadastrale 3096, volum 8, faqe 115, me sipërfaqje 3.200 m2, nga të cilat ndërtesa ka sipërfaqje 166 m2, në bashkëpronësi të YAHIA Muhamed Zakaria FARWATI dhe BRIXHILDA Baltjar FARWATI, me adresë: Qerëkë, KRUIJE.

ÇMIMI 114.500 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Reagon avokati Vladimir Meçe: Akuzat të stisura, gjykata në presion

# Gjovënie dhe krijim i grupit kriminal, dënohet me 14 vjet heqje lirie Emiljano Shullazi

Krimet e Rënda japin 55 vjet burg për gjithë bandën

TIRANË

Pas afro 50 seancash gjyqësore ka marrë fund saga "Shullazi" në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Në seancën e zhvilluar ditën e djeshme, kjo gjykatë ka dënuar me 14 vjet burg "kokën" e këtij grupi kriminal, Emiljano Shullazi. Ky i fundit u shpall fajtor për akuzat e gjovënieve dhe krijimit të grupit të strukturuar kriminal, ndërsa u shpall i pafajshëm për akuzën e presionit dhe kanosjes ndaj dy rektorëve Mynyr Koni e Dhori Kule dhe atë të shkatërrimit të pronës, për vendosje tritolit biznesmenit Jani Zaka në Tiranë dhe Adriatik Kuçuku në Lushnje. Gjithashtu, trupa gjyqësore e drejtuar nga gjyqtari Fran Prendi dha vendimet dhe për 4 anëtarët e tjerë të grupit në fjalë. Konkretisht, gjykata vendosi dënimin me 12 vite burg për Gilmando Danin; 10 vjet burg për Indrit Qyqjan; 10 vite burg për Indrit Zelën si dhe 9 vite për Blerim Shullazin. Gjykata dha një masë shtrënguese, që të pandehurit të mos përfitojnë nga drejta e lirisit me kusht, ndërsa dënimin do e kryejnë në një burg jo të sigurisë së lartë. Në total, Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë 55 vite burg për anëtarët e bandës, ndërsa prokuroria kërkoi 64 vite për 5 të pandehurit. Procesi gjyqësor u zhvillua nën masa të rrepta sigurie të Krimeve të Rënda, ndërsa seanca u monitoruar nga përfaqësues të ambasadës amerikane dhe asaj gjermane. Trupit gjyqësor iu deshën rreth 3 orë e gjysmë për të marrë vendimin final për bandën e Emiljano Shullazit. Pas vendimit të dhënë dje nga Krimet e Rënda ka reaguar avokati i Shullazit, Vladimir Meçe. Ai tha para mediave se akuzat janë të stisura. Po ashtu, Meçe nuk kurseu as kritikën për gjykatësit e kësaj çështje, ndërsa u shpreh se ata nuk bëjnë dot dallimin mes të drejtës civile e penale. "Është fatkeqësi. Pati edhe akuzë që ranë poshtë nga gjykata. Duhet të binin edhe këto akuzë. Vendimi s'ka asnjë dëm dallasim mes të drejtës civile, penale dhe administrative. E konsiderojnë një konflikt të pastër civil, si një veprë penale. Akuzat janë të stisura", deklaroi Vladimir Meçe.

## DËNIMET PËR GRUPIN "SHULLAZI"

1. EMILJANO SHULLAZI 14 VJET
2. GILMANDO DANI 12 VJET BURG
3. ENDRI QYQJA 10 VJET BURG
4. ENDRI ZELA 10 VJET BURG PËR
5. BLERIM SHULLAZI 9 VJET BURG



## "Të dënohet edhe deputeti Çyrbja"

Vendimi për bandën e Shullazit, PD: Betejë e pa fituar plotësisht

Pas vendimit që dha Gjykata e Krimeve të Rënda, duke dënuar me 55 vite burg në total bandën "Shullazi" PD e cilësoi si një betejë të pafituar plotësisht. PD shprehet se nëse Emiljano Shullazi dhe banda e tij, nuk do të kishin mbështetjen e qeverisë së Edi Ramës, dënimi i bandës do të ishte sot shumë më i rëndë. "Sot (dje) gjykata dënoi bandën e Emiljano Shullazit, që u arrestua vetëm falë denoncimit dhe betejës së pandërprerë të PD, si dhe mbështetjes së SHBA. Nëse Emiljano Shullazi dhe banda e tij, nuk do të kishin mbështetjen e qeverisë së Edi Ramës, dënimi i bandës do të ishte sot shumë më i rëndë. Dënimi i bandës së Shullazit është një betejë ende e pafituar plotësisht. Prapa hekurave duhet të jenë edhe anëtarit me pushtet politik i bandës, deputeti i PS Jurgis Çyrbja. Përgjimet e prokurorisë faktojnë se deputeti Jurgis Çyrbja ishte një anëtar aktiv i bandës së Shullazit dhe informonte bandën për hetimet e prokurorisë", thuhet në njoftimin e PD. Sipas demokratëve: "Shqiptarët presin sot përgjigje nga prokuroria: kur do të arrestohet dhe të vihet përpara drejtësisë Jurgis Çyrbja, si anëtar i bandës së Emiljano Shullazit? Drejtësia do të bëhet e plotë! Edi Rama, Saimir Tahiri dhe Jurgis Çyrbja, shumë shpejt do të kenë fatin e Shullazit!".



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

## OPEN CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST for the establishment of a pool of national civil engineering and/or architect experts to conduct engineering investment works of facilities in project area

### 1. Brief background of the programme

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH is implementing on behalf of the German Government the project "Climate-friendly, integrated waste and recycling management (CFISWM)". During the period June 2017 to March 2018, the CFISWM project supported the three Municipalities, Himara, Peqin and Rrogozhina in preparing Integrated Municipal Solid Waste Management Plans. The Integrated Municipal Solid Waste Management Plans in Himara and Rrogozhina, had foreseen that the pre-treatment of solid urban waste (sorting and composting) will be performed at the Himara, Vumblo Transfer Station. The process of treatment of recyclable waste materials will be collected and processed in Rrogozhina Collection Centre.

### 2. Purpose of the call for expression of interest and application procedure

This open call for expression of interest is intended to cover short term assistance of project support for engineering investment works of sorting and composting/stabilization facilities for municipal solid waste. **The Application deadline:** is 21 November 2018.

On the basis of the information provided in the application, the Programme assesses whether the applicants meet the criteria laid down below. The applicants will be informed by the Programme not later than **30<sup>th</sup> of November 2018** whether they have been included in the pool of potential experts or not.

### 3. Scope of work and description of main tasks

#### Scope of work

Finalising Documents for Detailed Design,  
Preparation of Tender Documents and Participation in Awarding Process  
Carry out Site-supervision/ Implementation  
Participation in the Final Acceptance  
Hand Over Process including Documentation

#### Description of main tasks

- Preparation of the final design plans for construction
- Draft the implementation project which includes the preparation of all necessary documentation
- Preparation of an explanatory report for the planned facility
- Preparation of a cost estimate for the buildings and outdoor facilities
- Prepare tendering documents
- The Consultant shall assume all engineering functions and duties in accordance with the contractual provisions made between GIZ and the building contractor
- All Technical Services as supervisor

### 4. Required skills and experience

- Construction engineer and/or architect diploma
- At least 8 years of technical competence and professional experience in construction design and supervision works
- Very good analytical capacity, interpersonal and communication skills and reporting;
- **Very good command of written and spoken English and computer literate;**
- **Experienced in working in a multidisciplinary team;**

### 5. Documents to be provided

Experts interested in the call are invited to send their application at any time prior to 21/11/2018. Each application shall include the following documents:

- **a motivation letter** explaining why the applicant would like to be part of these pool of experts and what experience he/she has related to the scope of work
- **diploma and Curriculum Vitae** (curriculum vitae – CV, in the European format, preferably not exceeding 3 pages).
- Additional supporting documents (e.g. publications or references) may be requested at a later stage.

All documents shall be submitted in English, by electronical means at the following address [hermann.plumm@giz.de](mailto:hermann.plumm@giz.de) or [artur.galanxhi@giz.de](mailto:artur.galanxhi@giz.de)



Edison Harizaj



Genci Caca

**TIRANË** - Viktimat e atentatit në Durrës para se të vriteshin, darkuan me disa shokë në një lokal në periferi të Tiranës. Edhe autorët e krimit besohet që janë nisur nga Tirana, kurse Durrësi u zgjodh si vend i përshtatshëm për ekzekutimin. Janë provat më të reja të zbuluara nga grupi hetimor për ngjarjen e disa ditëve më parë në qytetin bregdetar, ku mbetën të vrarë i ashtuquajtur "faqedjeguri" Edison Harizaj dhe shoku i tij, Genci Caca, të dy nga Vlorë.

## "Kam parandjenjë të keqe", "Il Padrino" i Vlorës, Edison Harizaj zbuloi se ndiqej nga atentatorët

Referuar dëshmitë të personave të fundit, me të cilët Harizaj është shoqëruar, një burim policor i tha "ABC News", se ai kishte pikasur ndjekjen. "Il Padrino", i njohur në Vlorë si person i rrezikshëm, është shprehur te një mik i tij, "Po më ndjekin, kam parandjenjë të keqe". Dhe në fakt, mbi të dhe Cacën

u zbrazën mbi 50 plumba edhe pse makina ishte gjysmë e blinduar. Ndërkohë, policia ka siguruar një dëshmitar, i cili flet për disa autorë pjesëmarrës në krim. Veç atyre që qëlluan makinën, një tjetër makinë ka mbikëqyruar vepërimet. Kur automatjet e viktimave dhe e autorëve u futën në rrugën dytësore, një mak-

inë e tretë ka qëndruar pak sekonda në anë të rrugës kryesore. Sapo është kryer ekzekutimi, ajo ka lëvizur në drejtim të Plepave. Në makinën e Harizajt, i njohur edhe si shoku i Emiliano Shullazit, policia ka gjetur tre celularë, dy të Harizajt dhe një i Cacës. Të tre të koduar.

Të akuzuarit kërkuar lirinë, vendimi i Krimeve të Rënda jepet të enjten

**TIRANË**

Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka shtyrë për të enjten, seancën gjyqësore ndaj personave të arrestuar gjatë operacionit të koduar "Vol-Vo 4". Në një kohë kur dje 24 anëtarët e grupit të Shijakut dhe të Lezhës, duke përfshirë edhe dy ish-deputetët socialistë Arben Ndoka dhe Arben Çuko kërkuar lirinë, vendimi për shqyrtimin e masës së sigurisë është shtyrë për në datën 15 nëntor, seancë që do të nisë në orën 13:00. Në seancën e djeshme ishin të pranishëm vetëm 16 prej tyre, ndërsa 8 të tjerë, duke përfshirë edhe dy ish-deputetët socialistë Arben Ndoka dhe Arben Çuko nuk morën pjesë, por u përfaqësuan nga avokatët e tyre. Mes të pranishmëve në seancë ishte edhe njëri prej të arrestuarve të operacionit, i cili pohohet të jetë dhe koka e grupit të Shijakut. Bëhet fjalë për Astrit Avdylin, i cili ka apeluar masën e sigurisë "Arrest me burg" dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Ndërsa ka kërkuar lirinë, Avdyli ka bërë deklaratë në sallën e gjyqit. "Rroftë Dako, rroftë PS, aty i qaj hallet", është shprehur i pandehuri. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dëshminë e Astrit Avdyli para trupës gjyqësore ku ai foli edhe për njohjet, ndërsa ka pohuar se Ndokajt i kishte miq. "Ndokajt i kam miq, i kam njohur në burg", tha ai. Teksa ka vijuar të rrëfijë njohjet me Vangjush Dako, Avdyli deklaroi se i ka shërbyer kryebashkiakut, pasi ka besuar tek programi i tij dhe i Partisë Socialiste. "Vangjush Dakos i kam shërbyer. Besoj në programin e tij dhe të PS-së. Kam qenë i persekutuar, kam bërë burg politik", u shpreh Astrit Avdyli. Emri i Dakos për lidhjet me vëllezërit Avdyli doli para disa ditësh pas publikimit të tri përgjimeve para dhe pas zgjedhjeve të vitit të kaluar. Në njërin nga bisedat e përgjuara, Vangjush Dako gjatë komunikimit me Altin Avdylin interesohet që të takohet me një person tjetër i quajtur Astrit, që është Astrit Avdyli. Sipas transkriptit të kësaj bisede me Altin Avdylin, Vangjush Dako kërkon të takohet me vëllain e tij, Astritin për ta falënderuar dy ditë pas zgjedhjeve të 2017-ës.

# Apeli shtyn vendimin e për 24 të arrestuarit e "Vol-Vo 4", Astrit Avdyli: Rroftë Dako e PS!

"Aty i qaj hallet. Besoj në programin e kreut të bashkisë dhe socialistëve. Ndokajt i kam miq"

**OPERACIONI**

Më 22 tetor, Policia e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe në bashkëpunim me agjencitë tjera ligjzbatuese finalizuan një megaoperacion të koduar "VOL-VO 4", të shtirë në 12 qytete nga Hasi deri në Sarandë, ku u goditën anëtarë nga 4 grupe të skeduar kriminale, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit".



Seanca gjyqësore të Krimit e Rënda

## Reagon ish-kryeministri Berisha: Bien maskat, rroftë partia e krimit!

**TIRANË** - Pas deklaratave befasuese të Astrit Avdyli, një prej personave të arrestuar si pjesë e bandës së Shijakut në kuadër të operacionit "Vol-Vo 4", që përfshinë edhe emra të njohur të politikës, ka reaguuar ish-kryeministri Sali Berisha. Ky i fundit përmes një postimi në "Facebook" theksoi se maskat ranë pas deklaratës në sallën e Gjykatës së Krimeve të Rënda nga Avdyli, i cili shprehte hapur mbështetjen për kryebashkiakun Vangjush Dakon




dhe simpatinë për PS. Mes ironisë Berisha shkruan "Rroftë partia e krimit". **"BIEN MASKATI"** Rroftë partia e krimit, organizata kriminale, Par-

tia Siçiliste me në krye Kryekumbar Edvinin, "Rroftë Gjush Avdyli" thërrret Tit Avdyli (Niçja i Dakos) në sallën e gjyqit! Sb", shkruan Berisha.

Në seancën gjyqësore që u zhvillua më 24 tetor në Gjykatën e Shkallës së Parë në Lezhë dhe tek Krimet e Rënda në Tiranë, nga 34 të arrestuarit si pjesë e operacionit "Vol-Vo 4", në burg u lanë 24 prej tyre. Ndërsa 10 u liruan, nga të cilët 8 në arrest

shtëpie dhe 2 me detyrim parqitje. Ndoka dhe Çuko patën kërkuar veçimin e dosjes së tyre nga bandat, por kërkesa nuk u pranua nga trupa gjyqësore. Më 22 tetor, Policia e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe në bashkëpunim

me agjencitë tjera ligjzbatuese finalizuan një megaoperacion të koduar "VOL-VO 4", të shtirë në 12 qytete nga Hasi deri në Sarandë, ku u goditën anëtarë nga 4 grupe të skeduar kriminale, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit".



Dako: Për të qarë edhe Avdyli, edhe Luçi!

PD: Dëshmia e Avdyllajve provon se Gjushi është peng i krimit

PD kërkoi sërish dje arrestimin e kreut të bashkisë së Durrësit Vangjush Dako. Deputeti demokrat Luçiano Boçi u shpreh se dëshmia në gjyq e njërit prej anëtarëve të bandës së Shijakut, Astrit Avdyli, i cili u shpreh "Rroftë Dako, rroftë PS, aty i qaj hallet" dëshmon se Vangjush Dako është peng i krimit. Sipas tij Dako duhet të ishte në burg për krimin e blerjes së votave nëpërmjet krimit. Pas deklaratave një prej personave të arrestuar si pjesë e bandës së Shijakut në kuadër të operacionit "Vol-Vo 4", Astrit Avdyli, i cili përfshinë edhe emra të njohur të politikës, reagoi edhe ish-kryeministri Sali Berisha. Berisha shkruan në "Facebook" se maskat ranë pas deklaratës në sallën e Gjykatës së Krimeve të Rënda nga Avdyli, i cili shprehte hapur mbështetjen për kryebashkiakun Vangjush Dakon dhe simpatinë për PS. "Bien Maskat! Rroftë partia e krimit, organizata kriminale, Partia Siçiliste me në krye Kryekumbar Edvinin, "Rroftë Gjush Avdyli" thërrret Tit Avdyli (Niçja i Dakos) në sallën e gjyqit! Sb", shkruan Berisha. Kurse kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako iu përgjigjur fjalëve të Avdyllaj si dhe reagimit të bërë nga Luçiano Boçi, i cili kërkoi sërish arrestimin e tij, duke shkruar se është peng i qeshur dhe për të qarë. "Njëri del në gjyq dhe mirë që nuk kërkoi edhe krehër para pushkatimit të togës gjermane... Tjetri del tek partia dhe kërkon llogari nga unë për një deklaratë qesharake që flet vetë më shumë se çdo koment për autorin!", shkruan Dako. Edhe LSI akuzoi përmes sekretarit të Përgjithshëm, Endrit Braimllari se pailigjshmëria e Edi Ramës synon mbrojtjen e bashkëpunëtorëve të tij, Vangjush Dako dhe ministrat e tjerë të lidhur me botën e krimit të organizuar në Shqipëri.









Table with 20 columns: ID, FERDINAN D, KAKARQI, ADELINA FERDINAND, RUSHAJ, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V. Rows include names like 8337 OEMAL OYTYKU, 5458 QERIM SELMANI, 2679 EDP CAMI, 4589 KOZHA ZHU, 324 EMN JERO, 10234 KOSTA KASHARA, 9249 Qerim Shehu, 12666 ABAS DELIALISI, 11554 KITA BELLA, 7147 BAHRI OMARI, 8697 HYSEN SAKOLLARI, 7644 MECAN HOXHA, 8152 SIMO STEFO, 7611 DALIP MUSAJ, 9062 ISUF SELMANI, 16325 SALI NELAJ, 7513 ATP MERDANI, 10813 ISAM BAMI, 8133 SHUQRI ZEPNATI, 7988 FEZ/FEZIJ BORÇI, 15259 HAJRI KAFO, 11974 ZEF GJONAJ, 7429 BEKHET, 8746 MITO XHMITRI.

Table with 20 columns: FERDINAN D, KAKARQI, ROZALJA GURDA, MITO XHMITRI, XHMITRI, X, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V, V. Rows include names like 10416 HAKI PENGELI, 10708 GHENARO DABERDAKU, 9514 FADIL QZTI, 9796 LEK LLESHI, 9241 NAIQO PAPA, 982 SULO MALAJ, 11257 EDISON GJERGO, 8333 BRAHM VUCAJ, 10758 QAZIM KONICA, 8928 BEÇE SINOMERI, 10881 SHEFQET ALLA, 10359 MAHMUT TOCI, 11172 MARKO KATRO, 11173 PETRAO KATRO, 11021 SELMA SKAJOI, 8418 SABRI KAPOLLARI, 7303 HAJRI MANE, 7319 FEIM STRATAJ, 7526 HEKURAN ZONJA, 7122 GJERGJ KOMINO, 7120 BEC NDREKAJ.

12 - SPECIALE

E mërkurë 14 Nëntor 2018

GAZETA SHQIPTARE

Table with columns for name, gender, and date. Rows include names like RUSTA, THOMAS, SHYQYRI, etc.

Table with columns for name, gender, and date. Rows include names like SALLI, HAJDAR, JONUZ, etc.

(vijon neser)

# VIP

Suplement  
Pages

Emërkurë 14 Nëntor 2018 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Grida Duma ndryshon 'look', lamtumirë flokëve të errët
- Zbulohet konflikti i hershëm i Meghan Markle me mbretëreshën
- Mesazhi i Tahirit: Faleminderit për mbështetjen, por që sot e tutje...
- Ndeshja Librazhdi-BE, Balla publikon foton e ditës


Një burrë për Dafina Zeqirin! Ja kujt i propozon për martesë këngëtarja



Del hapur Elita Rudi, rrëfen më në fund se si pondohej gjatë shtatzënisë



Flet gazetarja: Po punoj për të realizuar ëndrrën e fëmijërisë



# Nerilda Meda:

## Më pëlqejnë sfidat, me "Telesport" guxova

*"Vajzat me punë dhe vullnet mund të bëjnë gjithçka që meshkujt mendojnë se e bëjnë më mirë"*

Flet gazetarja: Po punoj për të realizuar ëndrrën e fëmijërisë

# Nerilda Meda:

## Më pëlqejnë sfidat, me "Telesport" guxova

*"Vajzat me punë dhe vullnet mund të bëjnë gjithçka që meshkujt mendojnë se e bëjnë më mirë"*

Pamela Aliaj

**P**sioni për gazetarinë dhe jo vetëm i çon njerëzit të zgjedhin se cila është rruga e duhur për ta. Por shumë prej nesh nuk kanë vetëm një ëndërr apo një pasion. E tillë është dhe gazetarja simpatike e "Telesport", Nerilda Meda, e cila nëpërmjet një interviste për "VIP Pages" të "Gazeta Shqiptare" na rrëfen të pathënat e punës së saj në këtë televizion. "Kam shumë ëndërra - thotë Nerilda - dhe po punoj shumë për t'i realizuar. Unë besoj se vajzat, me punë dhe vullnet mund të bëjnë gjithçka që meshkujt mendojnë se e bëjnë më mirë". Pra, kur pasioni që ke përbën dhe punën e përditshme, atëherë nuk ke për të punuar asnjë ditë të jetës tënde. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

**Prej pak kohësh jeni pjesë e një stafi të një televizioni sportiv. Pse zgjidhët pikërisht të bënit rolin e një gazetareje sportive?**

Unë besoj se vajzat, me punë dhe vullnet mund të bëjnë gjithçka që meshkujt mendojnë se e bëjnë më mirë. Jo vetëm që zgjidha gazetarinë sportive, por guxova duke pranuar ofertën e ardhur nga televizioni i parë sportiv në vend, sepse më pëlqejnë sfidat. "Telesport" është media nga kanë dalë shumica e gazetareve sportive në Shqipëri dhe ta nisësh gazetarinë sportive ngakry ekran është privilegj. Aktualisht lajmet e shkruara nga unë në "telesport.al" lexohen nga të paktën 100.000 lexues në ditë, pra përveç ekranit, kam edhe këtë "peshë mbi supë".

**Nëse do t'ju jepej mundësia të modernonit të një tjetër formati, çfarë do të zgjidhnit?**

Ekspëriencat e mëparshme në televizion gjatë këtyre viteve apo edhe pas kamerave, më kanë dhënë mundësinë ta njoh më mirë veten. Sociale, kulturre apo sport? Sport, sepse i përshatet pak natyrës sime sportive. E kam gjetur veten mirë në këtë fushë, më pëlqen dhe po mësoj shumë. Nuk kam ndër mend t'i ndahem sportit aktualisht.

**Sa e vështirë dhe e bukur është gazetaria sportive për Nerildën?**

Po t'ju them që edhe unë e kam paragjykuar gazetarinë sportive më parë, do të më besoni? Kam menduar se është e thjeshtë, por jo, është shumë e vështirë. Ka gjithmonë gjëra të reja që mund të mëson, shumë sporte, shumë rregulla dhe



kur punon me njerëz që kanë një jetë në këtë fushë, pret që të kërkojnë perfeksionin. Sa më shumë mësoj, aq më shumë zgjerohet hendeku i gjërave që nuk di. Por siç e thash më parë, kushdo mundet, por puna dhe vullneti duhet të jenë aty. Ama është sa e vështirë, aq edhe e bukur. Imagjinoni një punë nëpër stadione, pallate sporti, përcjell diçka që disa



njerëz e kanë profesion, të tjerë pasion e disa e ndjekin për t'u argëtuar; është padyshim bukur të punosh mes këtyre emocioneve.

**A e ndjeni që i përkisni 100% këtij profili?**

Mendoj se dua edhe pak kohë që të them, "po, unë kam lindur për këtë punë". Por, e bëj me pasion, shkoj në punë me dëshirë, marr kënaqësi nga çdo punë, sado e vogël. Edhe kjo intervistë me ju më jep grimca lumturie dhe është padyshim fryt i produkteve të realizuara me dashuri në "Telesport".

**Keni pasur propozime për të tjerë programe? Nëse po, pse i keni refuzuar?**

Kam pasur oferta nga media të tjera dhe u jam shumë mirënjohëse që më kanë vlerësuar, veçanërisht ftesa e një mikes sime së fundmi për t'u bashkuar një ekran të madh. Por, aktualisht ndihem mirë në familjen "Telesport". Kam hapësirën time për të bërë gjëra të bukura dhe po përfitoj shumë profesionalisht, duke punuar me gazetarë të këtij niveli dhe me një markë të vlerësuar.

**Si është rutina që ndiqni në një ditë pune?**

Në gazetari asnjë ditë nuk është e njëjllor, nuk ka monotonë në punën tonë. Një ditë mund të ndodhë të qën-

drosh gjithë ditën në terren, ditën tjetër gjithë kohës në zyrë. Por fatmirësisht unë jam pjesë edhe e departamentit të marketingut, pra ndërthur dy nga profesionet më pak monotone së bashku.

**Më mirë gazetare apo në marketing? Cilën do të preferonit më tepër?**

Ja, pse ndihem mirë në median ku punoj: kam mundësinë t'i bëj të dyja. "Telesport" është një markë me peshe në tregun shqiptar dhe ka transmetuar vlerë tek dashamirësitë e sportit që në konceptimin e saj, para 18 vitesh. Duke qenë se kam mbaruar studimet e larta në Fakultetin Ekonomik, Universitetin e Tiranës, nuk doja t'i largohesha profesionit për të cilin kam investuar kaq shumë, por doja të mbaja gjallë edhe pasionin, që është gazetaria. Për më tepër që masterin shkencor në marketing e zgjidha pasi punova në botën e medias dhe pash sesa shumë mund të ndihmonin njëra-tjetër dy fushat.

**Cili është sporti juaj i preferuar? A e praktikoni?**

E vogël kam qenë pjesë e një ekipi basketbolli, por duke u rritur, duke u distancuar nga çdo sport i mundshëm. Natyrshëm është sporti im i preferuar se e njoh që fëmijë, por më pëlqen edhe volejboli. Këto janë sporte që në "Telesport" i mbuloj unë dhe kolegja ime Brunilda Kazani, ndërsa në "telesport.al", i mbulon një gazetare me

një përvojë të gjatë, Gentian Spiri, nga i cili kam mësuar shumë për shumësportëshin. Futbollit më pëlqen shumë ta ndjek, për më tepër tani që po bëj "shkollë me profesorë shumë të rreptë", nëse do më pyesësh a di të luaj? Jam një katastrofë e vërtetë, shkaktoj shumë faulle. (Qesh)


**A e shihni të ardhmen në Shqipëri apo jashtë saj? Pse?**

Të ardhmes nuk i dihet, e kam menduar të largohem nga Shqipëria një ditë, ku i dihet "Sky Sports" mund t'i hedh sytë nga ne. Shaka (qesh). Besoj shumë të rinj e mendojnë largimin për një të ardhme më të sigurt në një vend me më shumë stabilitet, mua më pëlqen shumë Gjermania (jo vetëm sepse janë tifoze e ekipit të tyre kombëtar), por sepse adhuroj mënyrën e strukturimit dhe e organizimit të këtij shteti.

**Së fundmi, cila është ëndërra me madhe e juaja dhe a jeni duke punuar për ta realizuar atë?**

Ëndërra ime më e madhe? Unë kam shumë ëndërra, por po punoj për të bërë realitet ëndërrën e fëmijërisë, të bëhem një gazetare e suksesshme (jo kukull), që do t'i përcjell vlerë audiencës. Dhe së dyti, po punoj për të realizuar ëndërrën e 5 viteve të fakultetit, të qenurit një marketiere që nuk do të shesë, por të kujdeset për imazhin e një marke serioze.





Prej kohësh këngëtarja e njohur Dafina Zeqiri ka marrë vëmendjen e mediave rozë me postimet e ndryshme në "Instagram". Këngëtarja është bërë shumë aktive në skenën muzikore, prej kur ka vendosur të sjellë këngë të reja për tregun shqiptar. E megjithëse të gjitha këngët po i shndërrohen në hite, Dafina sërisht i kthen sytë nga Amerika. Këtë herë artistja ka bërë një veprim që ka befasiar të gjithë fansat, pasi ajo i ka propozuar publikisht martesë aktorit të njohur amerikan. Behet fjalë për Michael B. Jordan, aktorin që e duan të gjitha femrat. Dafina ka shkruar: "A do të martohesh me mua? Madje, edhe e ka etiketuar aktorin. Michael B. Jordan është i njohur për shumë role të tji, ndërsa së fundi pritet të paraqitet në pjesën e dytë të filmit me Sylvester Stalone, "Creed II", ku interpreton rolin kryesor, atë të Adonis Creed. Një zgjedhje shumë e mirë Dafi, por ende asnjë reagim nga aktori.

## Një burrë për Dafina Zeqirin! Ja kujt i propozon për martesë këngëtarja



E dhe pse nuk pranuan ta tregonin faktin e shtatzënisë, Elita Rudi më në fund ka filluar të shfaqë barkun e rrumbullakosur. Deri më tani është fshehur, por Elita Rudi tashmë ka thyer akullin dhe ka filluar të publikojë fotografi ku shihet shtatzëni. Së fundi, Elita vjen shumë elegante, ku duket se është zbukuruar edhe më shumë. Ajo shihet në një fustan të gjatë ndërsa mban barkun me duar, e për shtatzëninë Elita thotë se po e dashuron këtë periudhë. Elita për herë të parë ka vendosur të shfaqet shtatzëni në videoklipin më të ri të bashkëshortit të saj, Gjiko, ku merr pjesë si protagoniste. I ka dhënë vërtet nur shtatzënia!

## Del hapur Elita Rudi, rëfen më në fund se si po ndihet gjatë shtatzënisë



Po ta shohim nga fotot e mëparshme, nuk kemi për ta njohur kurrë Aurela Hoxha ka qenë një nga personazhet e njohur që s'ka pranuar asnjëherë për ndërhyrjet e saj në pamje. Ndërkaq, së fundmi ajo ka bërë një deklaratë mjaft shokuese. Modelja shqiptare ishte e ftuar në emisionin në "Pop Culture", ku përveç karrierës si modele, foli edhe për jetën e saj private. Ishte moderatori Kelvi Kadilli, ai i cili pyeti modelen nëse i paraqijkonte njerezit nga pamja e jashtme, e përgjigja e Aurelës nuk pritej! "Realisht po. Do doja të thosha, jo por i kam fobi njerezit e shëmtuar. Mami ma thotë gjithmonë se kisha një lloj si frike nga njerezit jo shumë të bukur. Mami më tregon që në klasë të parë, kishte një zotëri të shëmtuar që kishte shtëpinë afer nesh dhe unë ndërroja rrugën, sepse kisha frikë ta shihja. Unë i kam fobi njerezit e shëmtuar", tha modelja. Të jetë kjo arsyeja që Aurela kërkon perfeksionin nëpërmjet bistrisë?

## Nuk njihet nga operacionet, habit Aurela Hoxha me deklaratën: Kam fobi nga njerezit e shëmtuar



Sa shpejt kalojnë muajt dhe sa shpejt që rriten fëmijët! Dje ishte një ditë feste për çiftin e njohur të "showbiz"-it Ermal Mamaqi dhe Amarda Toska. Vogëlushja e tyre Sia ka mbushur plot 8 muaj. Ka qenë pikërisht Ami, e cila nuk i ka rezistuar publikimit të tortës së ditëlindjes së vogëlushes, që ishte vërtetë e veçantë. Por vetëm torta ka qenë në sfond të postimeve, ende nuk kemi parë fytyrën e vogëlushes së tyre Sia, duke u treguar mjaft të rezervuar. Ashtu si me Noelin, do të na duhet të presim disa vite për ta parë publikisht.

## Ditë e veçantë në shtëpinë e Amit dhe Ermalit, Sia mbush 8 muajshe


# BOULEVARDI

Na merrni seriozisht!

**POLITIK**

## Grida Duma ndryshon 'look', lamtumirë flokëve të errët

**G**rida Duma është një nga figurat më të njohura të Partisë Demokratike. Ajo ftohet shpesh në panele televizive, ku jep analizat e saj lidhur me fenomenet e ndryshme e sidomos situatën politike. Por tashmë në panelet televizive do të shohim një Gridë krejt tjetër përsa i përket 'look'-ut të saj. Parukieri i saj, Olti Shulla, ka publikuar fotot e transformimit të deputetes, e cila duket e mahnitshme. Flokët e errët ishin ata që e identifikonin politikanen, por tashmë Grida shihet me balluke dhe flokët me fije, tërësisht me një 'look' të ri. Grida njihet si një nga femrat më tërheqëse të politikës dhe më gjerë, të të gjithë ekranit shqiptar.



## Mesazhi i Tahirit: Faleminderit për mbështetjen, por që sot e tutje...

**I**sh-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, edhe pse larg politikës vijon të jetë aktiv në rrjetet sociale. Herë pas here ai ndan me ndjekësit momente nga jeta e tij private, por edhe mesazhe të rëndësishme në lidhje me çështjet që e preokupojnë. Së fundmi, Tahiri ka njoftuar mijëra mbështetësit e tij në rrjetet sociale se nuk do të jetë më aktiv në profilin në "Facebook", por i bën thirrje të bashkohen në një "Fan Page" të menaxhuar prej tij dhe bashkëpunëtorëve. "Faleminderit për mbështetjen në këtë faqe, por për arsye teknike, që sot e tutje mund të mbetemi në kontakt në të vetmen faqe që administrohet prej meje dhe bashkëpunëtorëve të mi! Nqs ia rekomandon edhe miqve të tu, akoma me mirë", shprehet Tahiri.



## Zbulohet konflikti i hershëm i Meghan Markle me mbretëreshën

**D**ukesha e Sussex-it, Meghan Markle, akoma pa kaluar një javë nga dasma e famshme mbretërore e 19 majit, u detyrua të merrte menjëherë leksione rreth etikës dhe historisë së familjes mbretërore. Por nëse mbretëresha e kishte me ngut të "fuste" Meghan në rrugë të drejtë, nuk mund të themi të njëjtën gjë për kërkesat e nuses së re të shtëpisë ditën e dasmës. "The Sun" bëri të ditur se Meghan donte që në ditën e dasmës të mbante një kurorë me gurë smeraldi, por mbretëresha ka qenë kundër kësaj gjëje. Ajo ka debatuar me Harry-n dhe i ka thënë këtij të fundit se Meghan nuk mund të ketë çdo gjë që do. "Meghan e kishte shumë për zemër atë kurorë me smerald dhe Harry bëri namin kur i thanë që nuk mund ta përdorte. Për këtë ai debatoi me mbretëreshën", është shprehur një burim për "The Sun". Po ashtu, mbretëresha nuk ishte dakord që Meghan të mbante një vello, pasi ishte martesë e saj e dytë. Si përfundim, Meghan mbajti një kurorë platini me diamante të zgjedhur nga mbretëresha, por ia arriti të shfaqej në kishë krahas princit Charles, me vallon e dizenuar nga "Givenchy".



## Ndeshja Librazhdi-BE, Balla publikon foton e ditës

**N**ë sajë të inaugurimit të fushës së re të sportit të qytetit të Librazhdit është zhvilluar një lojë miqësore. Futbollistët e parë të KF "Sopotit" të viteve 1980, kur u krijua klubi, u vunë përballë përfaqësuesve të delegacionit të BE në Shqipëri. Në këtë ndeshje ka luajtur edhe kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla dhe kryebashkiaku i Librazhdit, Kastriot Gurra. Ndeshja përfundoi me rezultatin 1-1. Balla publikoi në profilin e tij në "Facebook" një foto të shëqëpatur nga ndeshja, të cilën e cilesoi edhe foto dite.



## ARRESTIMI I ISH-KRYEMINISTRIT ZHVILLIMET NE MAQEDONI

Politikani maqedonas duhet të vuante dënimin me 2 vjet për korrupsion

# Nikolla Gruevski: Kam kërkuar strehim politik në Hungari

*Pas shpalljes në kërkim ndërkombëtar, flet ish-kryeministri*

Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski kërkon strehim politik në Hungari, ndërsa më 8 nëntor 2018 duhej të futej në burg për të vuajtur dënimin me 2 vjet, për korrupsion. Vendndodhja u bë me dije nga vetë politikani përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". "Gjatë këtyre ditëve kam marrë kërcënime për jetën. Tashmë jam në Budapest, ku u kam kërkuar autoriteteve hungareze azil politik. Do të ngelem gjithmonë besnik ndaj çështjeve të Maqedonisë. Nuk do të heq kurrë dorë!", shkruan Nikolla Gruevski. Mbi Gruevskin rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës gjatë blerjes për nevojat e qeverisë të një "Mercedes"-i në vlerë rreth 600 mijë euro. Sipas mediave vendëse, kanë qenë rojet e tij, të cilët shprehen se e kanë parë Gruevskin për herë të fundit mbrëmjen e të enjtes së 8 nëntorit. "E lamë në shtëpi. Në momentin që ai do të dalë jashtë, na telefonon dhe ne vijmë dhe bëjmë detyrën tonë. Të premtën, ai nuk na telefonoi fare, por kjo për ne nuk ishte ndonjë çudi, pasi ai nuk dilte çdo ditë. Dhe që nga ajo ditë nuk e kemi parë më", - kanë thënë trupat e tij. Të hënën mbrëma Gjykata Supreme maqedonase lëshoi urdhër për arrestimin e ish-kryeministrit, ndërsa më 9 herët, të premtën me 9 tetor parlamenti maqedonas nuk arriti t'i heqë imunitetin deputetit Gruevski, pasi nuk u arritën 2/3 e votave. Pasi nuk u gjend askund, Gruevski u shpall në kërkim ndërkombëtar deri sa në momentin që ai vetë deklaroi që ndodhej në Hungari e ka kërkuar strehim politik.

### "TANKU"

Në rastin "Tanku", për blerjen e "Mercedes"-it luksoz me vlerë 600 mijë euro është i akuzuar ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ministria për Punë të Brendshme, Gordana Jankullovska dhe ish-ndihmësiministri në MPB, Gjoko Popovski.



Nikolla Gruevski dhe kryeministri hungarez Viktor Orban

### MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Oliver Spasovski, tha se përgjegjësinë duhet ta marrë gjykata, për shkak se nuk caktoi masën e paraburgimit për Gruevskin, por ia la atij në dorë të paraqitet në burg më 8 nëntor. "Ish-kryeministri Nikolla Gruevski, i cili është shpallur në kërkim pas urdhër-arrestit të lëshuar për rastin "Tanku", dje është kërkuar në shtëpinë e tij, ndërsa kërkimet do të vijojnë në disa vende. Po kryhen disa kontrolle".

## "27 prilli", personi brenda BDI-së ka informuar Gruevskin

Zbardhen në seancë zgjedhëse komunikimet e deputetëve të VMRO-DPMNE-së me ish-kreun e Kuvendit, Trajko Veljanovski natën e përgjakshme të 27 prillit vitin e kaluar. Ditën kritike Veljanovski është njoftuar nga ish-kryeministri Nikolla Gruevski se do të shpallet Talat Xhaferi kryetar. Gruevski informacionin e ka siguruar nga një njëri i BDI-së, që në SMS nuk dihet nëse është deputet ose jo.

### Gruevski i shkruan Veljanovskit.

"Informacioni nga BDI, nga njeriu që ka ardhur nga mbledhja me Talatin. Sot pasdite, rreth orës 17, me iniciativë të LSD-së do të bëhet zgjedhja e Talatit për kryetar Kuvendit".

Në orën 17:48, Veljanovski i shkruan shefit të sigurimit, Goran Gjoshovski. Ai kërkon që të ruhet vendi i tij dhe të mos lejohen deputetët e shumicës që të zënë ulësen e tij.



### Komunikimi mes Veljanovskit dhe Gjoshovskit

TV: "Qëndroni në gjendje gatishmërie".

GGJ: "Të gjithë e dinin, përfshi MPB-në".

Në orën 18:39 minuta, deputeti Ilija Dimovski shkëmben disa porosi me SMS me Veljanovskin.

Komunikimi i Veljanovskit me Dimovskin "E zgjedhën Talatin".

"Shih që deputetët të vijnë para kabinetit nëse je aty".

Për një momentin, Veljanovski i shkruan ish-ministrit të Shëndetësisë, Nikolla Todorov dhe kërkon nga ai që qytetarët të mblidhen. Më pas i shkruan deputetit Dimovskit dhe i tregon se populli po futet brenda në Kuvend. Një ditë më pas, Veljanovski zhvillon një bisedë me deputetin Kërsto Mukoski, i cili kishte hapur dyert bashkë me kolegun e tij, Sasho Vasilevski. Veljanovski i tregon Mukoski se veprimi i tij nuk vërehet mirë në kamerat e sigurisë.

### Komunikimi mes Veljanovskit dhe Mukoskit

"Më tregoi njeriu se nga dyert pothuajse asgjë nuk shihet. Ka një kamerë, por është nga larg dhe shfaqet terr".

"Puna me mua është mjaft serioze".

Disa ditë më pas, Veljanovski ka tentuar që përmes Xhevat Ademit dhe Artan Grubit të ndikojë tek ish-ministri i

Brendshëm, Agim Nuhiu, që shefin e tij të sigurimit, Goran Gjoshovskin ta lënë të lirë. Në komunikimet e mëhershme që u shpallën si dëshmi të siguruar nga telefoni i ish-kreut të Kuvendit Veljanovski vërehet se deputetët të caktuar të VMRO-së dhe struktura udhëheqëse në parti dhe funksione shtetërore kanë kontrolluar protestën "Për Maqedoni të përbashkët", duke i caktuar itinerar dhe program dhe duke i përzgjedhur njerëzit që do ta udhëheqin protestën. Përveç nga telefoni i Veljanovskit, indikacione për dëshmi të reja në procedurë pritë të dalin edhe nga nënkryetari aktual i Kuvendit, Vesel Mamedi të cilit më 27 nëntor 2017 pas një bastisjeje në shtëpinë e tij, me urdhër të gjykatësit të procedurës paraprake, policia i kishte konfiskuar telefonin celular.

## LEXIMI

# NIS PANAIRI I LIBRIT

## Ymeri: Në fokus, leximi pas rënies drastike

Fatmira Nikolli

Hapet sot në Tiranë në Pallatin e Kongreseve edicioni i 21-të i Panairit të Librit. Dje paradite, kryetari i Shoqatës së Botuesve, Petrit Ymeri tha para mediave se marrin pjesë të njëjtat shtëpi botuese, duke përfshirë edhe disa të reja nga Maqedonia e Mali i Zi, institucione të angazhuara me botimin e librit apo organizata jofitimprurëse që merren me librin. Gjatë ditëve të panairit (14-18 nëntor) do të ketë mbi 60 aktivitete prej shtëpive botuese ose shoqatës, në stenda apo në salla, takime të autorëve, përkthyesve, botuesve me lexuesit.

"Tema e këtij panairi është leximi. Ndoshta edhe të shtyrë nga diskutimet e shumta që janë bërë pas anketimeve të INSTAT dhe Shoqatës së Botuesve Shqiptarë për rënie drastike të leximit. Ju e dini konkluzionin e INSTAT se rreth 1 milion shqiptarë nuk kanë lexuar asnjë libër në kuadër të një viti. Edhe për këtë, por edhe për shumë arsye të tjera, sepse ky rezultat i anketimit të INSTAT ka shkuar pak a shumë në të njëjtën vijë edhe me rezultatet e anketimeve që kemi bërë ne, leximi ka rënë dhe arsyet janë të shumta, sociale, ekonomike, psikologjike apo arsimore", tha Ymeri. Ai bëri me dije se për këtë arsye është zgjedhur kjo temë, ndaj do të ketë aktivitete që lidhen me leximin. "Një prej tyre, më i rëndësishmi në Sallën Ovale të Pallatit të Kongreseve që mbahet më 15 nëntor, organizohet nga Shoqata e Botuesve. Diskutohet për leximin, prirjet e tij. Në takim do të ketë stu-



Botuesit në konferencën para panairit

diues, botues, autorë, përkthyes, pedagogë, mësues etj., për të diskutuar problemet e leximit dhe si mund ta përmirësojmë këtë gjendje". Sipas tij, kjo nuk është një situatë që ka ardhur as për disa muaj, as për disa vjet. "Kjo është një situatë e krijuar prej më shumë se dy dekada, gati pothuajse tri dekada. Ka qenë rënie e interesimit të shprehur, të institucioneve për lex-

*"Mbështetja minimale, por rëndësi ka besimi i lexuesve"*

imin, ndaj kemi ardhur në këtë gjendje. Për t'u përmirësuar gjendja, për të ardhur aty ku ishim, duhen përsëri 15 ose 20 vite të tjera. Por kjo do një angazhim të të gjithëve, të të gjithë operatorëve,

por në radhë të parë të institucioneve", tha ai.

Sa u takon çmimeve, Ymeri tha edhe këtë vit do të jepen disa. Çmimet e panairit e kanë ceremoninë ditën e shtunë, në orën 12:00. "Do

të japim dy çmime për autorë, dy çmime për përkthyes, çmimin inkurajues, ndoshta edhe çmim për letërsinë për fëmijë, por aty jemi pak dobët. Pra, do të kemi një sërë çmimesh. Kemi edhe çmime të veçanta, çmime speciale, meqë edhe situata këtë vit është speciale, pasi është viti Mbarëkombëtar i Skënderbeut", tha kreu i Shoqatës së Botuesve Shqiptarë dhe botuesi i "Diturisë", Ymeri.

I pyetur nga gazetaret lidhur me institucionet që mbështesin këtë event të rëndësishëm, Ymeri u shpreh se: "Kemi vetëm mbështetje nga Ministria e Kulturës, një mbështetje modeste dhe asnjë mbështetje tjetër. Përbën problem, por jemi mësuar tashmë me këtë situatë. E rëndësishme për ne është mbështetja te njëri-tjetri, gatishmëria për të marrë pjesë, përgatitja serioze e pjesëmarrjes në Panairin e Librit dhe akoma më i rëndësishëm, besimi i lexuesit. Kjo është mbështetja jonë më e madhe. Fakti që ne kemi lexuesin me vete, që pesë vite të panairit ky Pallati i Kongreseve është plot me lexues të gjitha moshave, fëmijë, fëmijë me prindër, të rinj, të reja, të moshuar, punonjëz, intelektual etj., kjo është mbështetja më e madhe", përfundoi ai.

## RRJEDHA E DASHURISË

Maria Idromeno

Autori zvicerano-britanik, Alain de Botton, një best-seller perëndimor, vjen në panairin e librit 2018 me botimin më të ri "Rrjedha e dashurisë", një gërshetim i romanit me udhërrëfyesin për marrëdhëniet në çift. Botton kryen një humlumtim të mençur dhe të hollësishtëm mbi kompleksitetin e marrëdhënies romantike dhe veçanërisht, martesën. Gjaktëtohtësia intelektuale dhe mprehtësia artistike ofrojnë një analizë të të gjitha etapave nëpër të cilat kalon një lidhje. Ai ndjek boshtin e së vërtetës fund e krye, duke mos u rrekur për asnjë çast ta manipulojë lexuesin me fraza kitsch apo t'i komunikojë atij pikërisht ato fjalë që ky i fundit do të donte

të dëgjonte. Botton guxon t'i paralajmërojë romantikët se marrëdhënia me një njeri, aq më tepër një marrëdhënie e shtrirë gjatë në kohë, nuk e ka aftësinë të mbetet e pandryshuar, në atë gjendjen statike të fillimit të saj, pra të pasionit marramendës dhe iluzioneve të ndryshme që ky i fundit provokon; se marrëdhëniet ndryshojnë së bashku me njerëzit.

Gjithashtu, ai ngre një pyetje të domosdoshme së cilës i jep përgjigje hap pas hapi: Ç'është dashuria? Ç'është kjo forcë vetëmohuese ndaj së cilës njeriu zgjedh me vullnet të plotë të robërohet? Por mbi të gjitha, a jemi ne të aftë ta shquajmë dashurinë e të mos biem për e formave të gjenjeshërta që mitizimi i saj ka krijuar? Botton përpiqet të shquajë se si dashuria materializohet në përditshmëri dhe nëse ka një shpresë për jetëgjatësinë e saj, pavarësisht problemeve (shpesh fatale) që mund ta shoqërojnë atë. Ai është një autor i matur dhe modest e nuk pretendon për asnjë çast të ketë çelësin të vërtetave absolute. Përkundrazi, duke na ftuar publikisht në



një diskutim të domosdoshëm, ai përqendrohet te forca dialektike e të arriturit në një përfundim logjik, duke dhënë sugjerime e arsyetime të larmishme; në prirje që mbase ne të ndalojmë gjatë rreshave për t'u menduar, ose për të dashur të flasim pothuajse si në terapinë e Illojt që ndjekin person-

azhet e tij apo së paku, thjesht të bluajmë vetmevetë gjithë sa na ofrohet. Mënyra se si ky autori i lëcurit e kryen zbërthimin e sjelljeve sociale dhe fenomenit më të rëndësishëm njerëzor, atë të krijimit dhe ruajtjes së marrëdhënies, është nëpërmjet zgjedhjes së një gjuhe të thjeshtë, një gjuhe që i flet gati çdo lexuesi dhe i shtjellon atij koncepte të komplikuar nëpërmjet frazash e shembujsh të përditshëm, lehtësisht të përvetësueshëm. Pikërisht këtu përmbledhet gjenialiteti i tij. Një tjetër mjeshteri e veprës është edhe aspekti psikologjik i personazheve. Botton na paraqitet si një njohës shumë i mirë i psikikës njerëzore kur zbërthen shkaqet e që i bën personazhet e tij - Rabinun (një burrë i ri lebanezo-gjerman, sentimental, i pasigurt) dhe Kirstenin (një grua e re skoceze, inteligjente, e pavarur, e fortë) - të ndërmarrin veprime si tradhtia, falja apo mëria. Ai përqendrohet në dijen psikanalitike për t'u dhënë kuptime sa më drejta sjelljeve dhe mendimeve që e përbëjnë një lidhje si ajo e Kirstenit dhe

Rabinut e më tutje, atë të të dyve me fëmijët që do të sjellin në jetë. Ironia e librit qëndron te fakti se po aq sa ç'të rrëmben në një lexim të lehtë e të shpejtë, po aq të angazhon pashmangshmërisht në të. Leximi ecën nëpërmjet shembujve të paraqitur në formën e novelës artistike, me dialogë që grishin kureshtjen dhe shtojnë etjen për lexim, sikurse të ndalesat e pashmangshme të të përtypurit të këtij materiali. Alain de Botton është një prej autorëve më të lexuar aktualë në botë sot. Ai ka botuar një sërë titujsh me tematika të ngjashme, mes të cilëve "How Proust Can Change Your Life" (1997), "The Architecture of Happiness" (2006), "The Romantic Movement" (1994), etj. Në Shqipëri ai njihet sidomos me esenë prozaike "Ngushëllimet e filozofisë" (2004), gjithashtu nga shtëpia botuese "Idemart". Më 2015 Festivali i Shkrimtarëve të Melbourne-it i dha atij çmimin vjetor për veprën "The Fellowship of Schopenhauer".

## PREMIERA

# "Ditari i Ana Frank", në skenë me paralelet shqiptare

Fatmira Nikolli

Unë i mbaj për vete idealet, sepse pavarësisht gjithçka je, vazhdoj të besoj se njerëzit janë të mirë në zemër" Ana Frank. "Ditari i Ana Frank" është premiera e re në Teatrin "Metropol", e cila do të ngjitet në skenë në datë 15 nëntor. Vepra, duke marrë shkas nga historia e vajzës hebreje gjatë Luftës së Dytë Botërore, shkruar nga Frances Goodrich dhe Albert Hackett ka fituar çmimin "Pulitzer". Në skenën e në Teatrit Metropol ajo i sjell publikut një copëz reflektive nga jeta e hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore jo si një qasje klasike, historike, por e ndërthurur edhe me realizimin magjik, me atë se çfarë ndodh realisht me hebrejtë.

"Ditari i Ana Frank" është një vepër universale, pavarësisht se ka ndodhur në Luftën e Dytë Botërore, 60 vjet më parë. Po të shohësh në Shqipëri histori paralele e njëjtë ka ndodhur me çamët gjatë fillimit të shekullit të kaluar. Është duke ndodhur aktualisht në Lindjen e Mesme, kështu që historia e Ana Frank dhe familjes së saj është një histori që përsëritet", tha regjisorja Armela Demaj. Sipas saj, për këtë arsye, "kemi zgjedhur që në shfaqjen tonë të mos flitet specifikisht çfarë u ndodhi hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore, por të trajtohet ajo që i ndodhi njeriut si qenie, atë çfarë njeriu i bëri njeriut dhe vazhdon t'i bëjë për shkak të ngjyrës, besimit, për shkak të bindjeve politike, preferencave sociale etj.", sipas Demaj, zëri përfaqësues i të gjithë këtyre njerëzve, atyre që kanë ikur dhe atyre që do vijnë është pikërisht "Ditari i Ana Frank", një vajzë në fillim të 13-tave dhe më pas 15-vjeçare, që është trashëgimi historike materiale e një lufte të çmendur dhe një çmendurie kolektive. "Ne njerëzit, aq sa jemi qenie të mrekullueshme, kemi njëkohësisht potencialin për të qenë mizorë. Zëri i Ana Frank është zëri i ndërgjegjes sonë", - tha Armela Demaj. Ajo ka punuar për këtë premierë me asistentregjisorin Edvin Mustafa, koreografin Enio Shehi, kostumografin Jonida Beqo dhe interpretimin e një trupe të madhe që sjell gjithë mozaikun e trishtit të kohës: Vanesa Guri, Myzafer Zifla, Klea Konomi, Kejtjona Pecnikaj, Bruno Shllaku, Marjana Kondi, Roerd Toçe, Marius Dhrami, Edvin Mustafa, Paola Xhafa, Sara Koçi, Sedmir Memia, Stivi Osmanaj, Mario Bali, Dinorah Beqiraj, Ezra Vogli, Valdano Bajram. Premiera është më 15 nëntor (deri 9 dhjetor) dhe shfaqja vjen në netë në vijim në orën 19:00.

## FAMILJA FRANK

Më 1940-ën, Gjermania pushtoi Holandën dhe filloi menjëherë zbatimin e ligjeve antihebreje. Babai i



Aktorët e shfaqjes

Ana Frankut, i frikësuar për familjen e tij me prejardhje hebreje, ra në tujdi me bashkëpunëtorët e bi-

znesit të tij për ta vazhduar punën në një vend të fshehtë, ku edhe do të fshiheshin derisa lufta të për-

Teatri "Metropol" sjell premierën, regjisorja: Njeriu, i mrekullueshëm e mizor



fundonte. Disa muaj përpara se familja Frank të fillonte të fshihej, Anës i dhuruan për ditëlindje një ditar. Ajo e quajti ditarin e saj "Kiti" dhe shkruante në të gjithçka i ndodhte asaj dhe familjes. Askush nuk e di saktësisht se si ndodhi që pas dy vjet e gjysmë strehimi, dikush u tregoi nazistëve për vendndodhjen e familjes Frank. Nazistët shkuan

në vendin ku gjendeshin Frankët, i morën dhe i dërguan në një kamp përqendrimi. Miep Gies, mikeshja e familjes Frank, e gjeti ditarin e Anës dhe e fshehu në një vend të sigurt, pasi shpresonte që Ana të kthehej pas përfundimit të luftës. Por kjo gjë nuk ndodhi. Nga familja Frank mbijetoi vetëm babai i saj, Otoja. Gruaja e tij u vra në Aushvic. Ana dhe motra e saj më e madhe humbën jetën në kampin e përqendrimit Bergen-Belsen, vetëm disa ditë përpara se kampi të lirohej. Oto Franku, me sugjerimin e disa miqve të tij, lejoi që ditarin i vajzës së tij të botohej. Kështu, Ditari i Ana Frankut u bë një ndër librat më të lexuar në botë dhe u përkthye në dhjetëra gjuhë. Shtëpia ku ishte fshehur familja Frank në Amsterdam, sot është e hapur për vizitorët. Aty gjendet edhe ditari që shkroi Ana, i cili ka vlerën e një dokumenti unik njerëzor.

## "NË VEND TË ADELËS"

### KONCERTI QË KUJTOI GAZETAREN DHE NDERIMI NGA BASHKIA E TIRANËS

Një bursë e plotë jepet në emrin e Adela Xhamanit, për një vajzë nga qyteti i saj

Këngë, kujtime, çmim për mesazhin që na dha me jetën e saj dhe një bursë studimi për një vajzë të re. Mbrëmjen e së hënës u mbajt në "ArTurbinë" koncerti humanitar "Në vend të Adelës". Vetëm pak ditë pas ditëlindjes së të ndërës Adela Xhamani, mori jetë një kauzë që ishte menduar shumë më herët, në biseda tavolinash mes gazetares dhe miqve më të mirë të saj. Një koncert që si synim parësor kishte jo vetëm të kujtonte Adelën, por përmes emrit të saj, t'i sigurohej shkollimi një vajze tjetër, që si Adela ka ëndrra për një jetë të re. Salla e madhe e "ArTurbinës" ishte mbushur plot, duke kaluar çdo pritshmëri. Njerëz që e njihnin nga afër, njerëz që e deshën nga ekrani u mblodhën bashkë në emër të saj. Eraldo Rexho, Iva Kalemi e Fatmira Nikolli dhe miq të tjerë të saj ishin kudo në sallë, duke mirëpritur të ftuarit, duke u marrë me çdo gjë që mbrëmja të shkonte siç e kishin planifikuar. Koncerti nisi dhe Arbana Osmani drejtoi koncertin. Mes emocioneve, ajo kujtoi kohën kur e takoi për herë të parë Adelën. Momentin e 10 viteve të shkuara, Arbana e tregoi me aq emocion sa lotët që vëshitirë të mbareshin. "Adela ishte banorja më e frikësuar që kisha njohur dhe si për iro-



Koncerti

ni, i gjithë 'Big Brother' mori emrin e saj", - kujtoi Arbana. I gjithë koncerti iu dedikua Adelës që të gjithë njihnin. Adelës që transmetonte aq shumë pozitivitet dhe që erdhi me ëndrra të mëdha në Tiranë dhe që ia doli t'i realizojë shumë prej tyre. Adelës që njihnin miqtë e saj më të ngushtë, Adelës që adhuronte muzikën, që këndonte duke ecur nëpër zyrat e mediave ku ka punuar nga "Gazeta Shqiptare", tek "News 24", nga "Top Channel" tek revista "Who", ku punoi si kryeredaktore dhe jetoi duke dashuruar gazetarinë, por mbi të gjitha jetën. Çdo këngë e

kënduar në koncert kishte një domethënie të veçantë për Adelën dhe duke sikur çdo melodi e sillte më afër me të gjithë të pranishmit. Ishin këngët që ajo dëgjonte me vullm të lartë, e këngët që këndonte me zë të lartë. Ishin këngët që patën shënjuar jetën e saj, a këngët që përshkruanin ëndrrat e saj - ishin këngët e Adelës.

Teksa fundi i mbrëmjes afrohej, në emër të Bashkisë së Tiranës, Adela Xhamanit ju akordua "Medalja e Mirënjohjes së qytetit", në nder të kontributit që ajo dha për shumë vite si gazetare dhe për rolin e rëndësishëm në eman-

cipimin e femrës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së tyre. Ky titull u tërhoq nga tezja e saj, Flutura Dedgjoni, e cila mes lotësh falenderoi pjesëmarrësit dhe tregoi krenarinë që ndjen për mbesën e saj. Disa fjalë të ndjera i tha edhe vajza që fitoi bursën e akorduar nga një universitet privat. Elma Isufi, një vajzë e thjeshtë, me ëndrra të mëdha dhe me arritje të shkëlqyera në mësim. Teksa doli në skenë, plot emocion u zotua se do përpigjet aq shumë sa Adela për të arritur suksesin. Me krenari ajo pranoi se mbi shpatulla tashmë mban edhe peshën e emrit të Adelës.

Artistët e ftuar e kujtan Adelën me fjalët dhe me këngët e tyre, ndërsa me krenari treguan sa të lumtur ndiheshin për pjesëmarrjen në koncertin që kishte një qëllim aq human. Koncerti u mbyll me Irma Libohovën, ndërsa në skenë për të thënë fjalën e mbyljes doli edhe Eraldo Rexho, producenti dhe mik i ngushtë i Adelës. Në përpjekje për të mbajtur lotët, ai mundi të thoshte vetëm pak fjalë: "Faleminderit! Për Adelën, për njerëzit që jeni. Nuk ka kënaqësi më të madhe sesa ta shoh plot sot këtë sallë. Kjo tregon që ia dolëm! Ia dolëm Adela!".

Opinioni **i** Ditës

# E vërteta vonon, por nuk harron!

Nga Blendi Fevziu

(vijnë nga faqja 1)

...mbërriti në Gjykatën e Shkallës së Parë në kryeqytet. Burri ishte librari më i njohur në Shqipëri, Mithat Frashëri, djali i Abdyl Frashërit, nipi i Naim dhe Sami Frashërit, firmëtar i Aktit të Pavarësisë së Shqipërisë, anëtar i Qeverisë së parë të Ismail Qemalit dhe ish-ambasador i Shqipërisë në Athinë. Që prej dy vitesh drejton-te në Tiranë librarinë "Lumo Skëndo", një vend kult i kulturës, dijes dhe albanologjisë. Njëherazi, vendi më frymëzues për rininë e qytetit të vogël që po shndërrohej pak nga pak në kryeqytet të Shqipërisë. Burri po bënte diçka jo të zakonshme për një 49-vjeçar. Po depozi-tonte testamentin e tij. Një testam-ent në të cili parashikonte që çdo gjë që kishte në këtë botë, ia linte Shqipërisë. Siç dëshmohet në parafrain e parë:

"Çë kam pasuri të tundshme ose të patundshme, libra, mobilla, karta, plaçka, para etj. i lë për krijimin' e një "INSTITUT ALBANOLOGJIE" që të jetë një qendër e studimeveve shqipëtare, të mprojë, të shvillojë, të qendrësojë dhe të udhëheqë studimet që përkasin Shqipërinë dhe Shqipëtarët."

Më tej vijonin një seri dhurimesh të tjera, përfshirë sendet personale të vëllëzërve Frashëri, paratë kesh dhe çdo gjë tjetër dhe në fund kishte vetëm një amanet: "Nuk di se ku do të vendoset INSTITUTI; po, në qoftë se goditetë (ndërtohet) pakëzë jashtë qytetit, do të donja që varri im të jetë në një cep të kopshtit, më të mëngjërë duke hyrë nga porta e rrugës; mbi këtë varr dua një copë gur të math dhenjë qiparis. Më duketë sikur do të jem ruajtësi i INSTITUTIT, sikur do të marr edhe unë një pjesë pasjetore në gjëllimin e tij."

Zhvillimet historike dhe fati i keq, sollën që as testamenti të mos zbatohet dhe as amaneti të mos zinte vend. Mithat Frashëri ndërroi jetë në një hotel në Nju Jork, më 1949, kur drejtonte Komitetin Shqipëria e Lirë, një qeveri në mërgim e njohur nga demokracitë perëndimore, që kontestonte regjimin komunist, diktatorial në Shqipëri. Ai u varros në Long Island, në varrezë komunale, ku çdo tetor grupimet antikomuniste zhvillonin homazhe dhe këndonin himnin e Flamurit. Të vetmen gjë që i bashkonte me kundërshtarët e tyre komunistë!

Shembulli i Mithat Frashërit është shembulli tipik i nëpërkëmbjes historike, shpjegimit të gabuar dhe padyshim përdorimit banal të historisë nga regjimi komunist. Pas pushtimit italian Mithat Frashëri së bashku me një grup intelektualësh të tjerë krijoi organizatën e Ballit Kombëtar dhe tentoi të bënte rezistencë ndaj pushtuesve. Në fillimet e tyre, Balli dhe komunistët dallonin në pak gjëra, por më thelbësorja ishte vizioni që kishin për Shqipërinë e pas luftës. Dy organizimet që kërkonin



në Shqipëri pa pushtues u përplasën ashpër edhe me tyre, duke i dhënë luftës karakteristikat tipike të një lufte civile. Komunistët fituan. Ata ndërjuan një shtet të ngjashëm me Bashkim Sovjetik dhe një nga diktaturat më të ashpra në botë. Të krahasueshme vetëm me Korenë e sotme të Veriut. Mithat Frashëri u largua nga Shqipëria. Ai bashkëpunoi me Britanikët dhe Amerikanët me idenë e rrëzimit të regjimit komunist, por dështoi. Nderroi jetë papritur më 1949, duke pasur mbi shpinë nga historiografa komuniste, damkën si tradhtar.

Nuk dua të zgjatim më shumë në analizën e baltës dhe përdhosjes ndaj tij. Njeriu që u bë butues i disa prej revistave dhe gazetave të rëndësishme shqip si "Dituria";

organizatori i Kongresit të Manastirit dhe Bashkëkryetar me Gjergj Fishtën i komisionit të alfabetit që vendosi alfabetin latin. Pra, njeriu që ka kontribut për shkronjat me të cilat shkruajmë gjuhën sot. Firmëtar i Aktit të Pavarësisë; Ministri i Qeverisë së Parë të Ismail Qemalit; Ambasadori i Shqipërisë në Athinë dhe mbi të gjitha kontribuuesi i pashembullit i Bibliotekës Kombëtare, u njollos, sepse në më pak se 2 vjet drejtoi një organizatë që kishte bindje të kundërta politike me komunizmin. Nuk dua të merrem me asnjë nga këto. Historia e ka zgjidhur tashmë maskaradën gjysmë shekullo-re. Dua të përsëris vetëm një thënie kaq të njohur: "E vërteta mbase vonon, por nuk humbet kurrë".

89 vjet më pas, amaneti i tij po bëhet realitet. Mithat Frashëri po

kthet në Shqipëri. Në Nju Jork, shteti Amerikan i ka organizuar një përcjellje zyrtare. Arkivoli i mbuluar me flamurin kombëtar, mbërrin në 14 nëntor në Tiranë, për t'u varrosur pranë babait të tij, Abdyl Frashërit dhe xhaxhait, Naim Frashërit. Në krah të Faik Konicës. Në kodrat e Liqenit. Aty ku qëndrojnë njerëzit që kanë një kontribut real për kulturën e këtij vendi. Ai i fali Shqipërisë gjithçka kishte. Gjithçka materiale, pasi i kishte falur më parë, thaujae gjithë jetën e tij. Shqipëria i ktheu sot, borxhin që i kishte prej dekadash: 2 metra varr, për ta mbajtur në gjirin e saj!

Mirë se u riktheve në atdhe Mithat Frashëri!

Më poshtë, testamenti i plotë i Mithat Frashërit deponuar në Gjykatën e Tiranës më 4 Mars 1929! "Tiranë 4 Mars 1929

Unë, Mithat Frashëri, në shëndet trupor të plotë, po bënj këtë testament, duke ushqyer shpërsenë se pas vdekjes s'ime do të ekzekutohet pikërisht vullneti që dëftën këtu:

1) Çë kam pasuri të tundshme ose të patundshme, libra, mobilla, karta, plaçka, para etj. i lë për krijimin' e një "INSTITUT ALBANOLOGJIE" që të jetë një qendër e studimeveve shqipëtare, të mprojë, të shvillojë, të qendrësojë dhe të udhëheqë studimet që përkasin Shqipërinë dhe Shqipëtarët.

2) Dua që nga biblioteka private ime të mos çkeputetë gjë; të gjitha librat të rrinë tok.

3) Gjithë sa më kanë mbeturë nga im atë dhe nga unjërit, dhe që sot formojnë muzenë t'ime fa-

miare, dëshëronj që të ruhenë prapë në formë të një muzeje të vogëlë, brënda në INSTITUT.

4) Në paça të holla, në shtëpi, më no një bankë ose hua për të mbledhurë, duke u bashkuarë me sumën që do mirret nga shitja e Librarisë, dua që të përdorenë të gjitha së bashku.

1. A) për të bërë spenximet e parë e një godije (shtëpie) e cila të shërbejë si INSTITUT ALBANOLOGJIE, një godi e mjaftë për të nxënë bibliotekën dhe për zyrratë. Dëshira ime është që kjo shtëpi të jetë mjaft' e gjerë s' për të pasur një ose dy oda ku të mundin të bujtin dhe të rrinë musafirë studimtarë albanologë të huaj që vijnë së jashtmi.

2. B) Në qoftë se, në vdekjet t'ime, kam mundurë të godit vetë no një shtëpi, INSTITUTI do të instalohet atje. Atëherë të hollat e prodhuara, si them më siprë, do të vihenë në një bankë të sigurtë dhe interesi i tyre, do të përdoret për qëllimin e INSTITUTIT, sidomos për të shtypurë libra ose për të enkurajuarë botimin e tyre.

5) Librarija ime dëshëronj që të shitet ashtu si është, e tërë bashkë, jo copa copa, dhe, në qoftë e mundurë, të mbanjë emërin që i kam dhënë unë.

6) Libravet të INSTITUTIT t'u vihëtë vula ime "Biblioteka Lumo Skëndo 1897" dhe t'u ngjitetë Ex-libris. Vula do të gjendetë në tryezën t'ime, në shtëpi, e gatijtë, kur se ex-libris është vetëm një skicë bërë prej Hyshref Frashërit.

7) INSTITUTI do të jetë nënë këqyrjen e një Komisioni, bërë prej:

dhe Muzes' së Shtetit në Tiranë, (Bibliotekë dhe Muze Kombëtare);  
2. b) Kryetarit të Bashkis' së Tiranësë;

3. c) Një funksionari të Ministris' s' Arsimit

4. d) Kryetarit të Diktimit Civil;

5. e) Drejtorit të institutit arsimor shqipëtar më të lartë të Tiranësë.

8) Për të zbatuarë testamentin t'im dhe për të ngrehurit e INSTITUTIT lë si të ngarkuarë prej meje këta Zotërinj: Niazi Tirana, Sotir Kolea, Dimitri Berati, Mehdi Frashëri dhe Edhem Fuad Frashëri. Zotit Niazi Tirana i ap barrënë që të kujdesetë edhe si një notabl i Kryeqytetitë.

9) Në qoftë se një prej këtyre zotërinjve gjendetë absent, për një ose tjetër shkak, në kohë të vdekjes' s'ime, atëherë do të zërë vëndin e tij, ose të tyre, Athanas Shundi, farmacist në Tiranë dhe Hasan Toptani, biri i Kurad Toptanit; me të mos ndodhurë më tepër se dy, ata që gjendenë janë të ngarkuarë të zgjedhin aqë anëtarë sa mungojnë prej numurit që shënonj unë.

10) Ngarkonj prapë Baban e Teqes' së Frashërit, Kryetarin e Bashkis' së Frashërit dhe më plakun nga anëtarët e Bashkis' së Frashërit, të kenë mirësinë dhe të kujdesenë për mbarimin' e dëshirës' s'ime që shtonj në këtë testament, do në fillesë të punësë, do edhe çdo mot duke kërkuarë që të botohen edhe çdo mot, duke kërkuarë që të botohetë vepri dhe bilançoja e INSTITUTIT.

11) Ushqenj besimin e plotë se kjo dëshirë ime do të zbatohetë besnikërisht prej pasanikëve të mij ndë gjithë shekujt që do të vijnë, dhe lutja ime drejtuarë fuqis' së madhe që tani s'e kuptojmë dot, do të jetë të kenë gjithë Shqiptarët idealin e përparimit dhe të naltësimi të Kombit, që Shqipëtarizma të bëhetë një dëshirë dhe një konviktim i thellë, dhe që çdokush të kupëtojë se e mira e Kombit është dhe e mira jonë private, se nderi i dhe lavdi i Shqipëtarëve të gjithë, është edhe nderi dhe lavdi ynë personal.

12) Nuk di se ku do të vendoset INSTITUTI; po, në qoftë se goditetë pakëzë jashtë qytetitë, do të donja që varri im të jetë në një cep të kopshtit, më të mëngjërë duke hyrë nga porta e rrugës; mbi këtë varr dua një copë gur të math dhenjë qiparis. Më duketë sikur do të jem ruajtësi i INSTITUTIT, sikur do të marr edhe unë një pjesë pasjetore në gjëllimin e tij.

Me këto dëshira dhe shpëresa po e nënëshkruaj me dorën t'ime këtë testament.

Mithat Frashëri  
Lumë Skëndo

Këtë testament e kam deponituarë ndë Notarijën' e Gjyqit të Shkallëq' së Parë të Tiranësë, me datë 4 Mars 1929 dhe me numurë 163.

Kopje të këtij testamenti u kam dorëzuarë Zotërinjvet:  
Niazi Tirana, Sotir Kolea, Dimitri Berati, Edhem Fuad Frashëri si dhe Babajt të Teqesë së Frashërit."

Opinion *i* Ditës

# Tradhtia e patriotizmit

Nga Koço Kokëdhima

(vijon nga faqja 1)

... që nuk kishte parasysh këtë liderin tonë rrënjëdalë, i cili çdo ditë mendon dhe punon vetëm për pasurinë, për pushtetin dhe për llogaritë e veta politike. Natyrshëm, nuk i binte radha që në fjalimin e mbajtur në përkujtim të mbarimit të Luftës së Parë Botërore, të merrej me kryeministrin shqiptar. Ky i fundit nuk ka ndonjë platformë në të mirë të shqiptarëve. Në Shqipëri, e kuptojmë fare mirë të gjithë se kryeministri ynë çdo ditë "tradhton patriotizmin".

Ky "nacionalisti" ynë modern është si Esat Pashë Toptani, që për interesin e vet ishte gati të shiste çdo copë të atdheut. Rama shkëlqet në Kuvendin sa herë t'i teket dhe e përdor nacionalizmin si fasadë, që në të besojmë se ai është patriot. Për të marrë kostumin e nacionalistit, i ndihmuar nga Fondacioni Soros, i rreshtoi shqiptarët e Maqedonisë në gjoja platformën e përbashkët dhe i propozoi interesat e tyre për qeverinë e Zaevit, pa negociuar kushtet dhe pa garanci për përmbushjen e të drejtave të tyre. Ata u vunë në këtë pozitë që të nënshkruhej marrëveshja e Prespës mes Tsiprasit dhe Zaevit, dhe meritat t'i merrnin maqedonasit dhe grekët duke i lënë shqiptarët jashtë tryezës. Ja ku jemi sot, kur ky "nacionalisti ynë" nuk ndihet tekta në Maqedoni nuk bëhet asnjë ndryshim kushtetues në favor të shqiptarëve.

Me imazhin e nacionalistit shkoj në Beograd dhe foli për pavarësinë e Kosovës, që, në fakt, kishte ndodhur një dekadë para ardhjes së tij në pushtet. Nga poshtë tryezës miratonte planet për shkëmbime e falje terrirore shqiptare. Në vitin 2015, ky pseudo-nacionalist bëri gjithë atë zhurmë për memorialin e Katalanos dhe të Misionit Bazilian që do të ngrihesh mbi rrënojat e kishës së Shën Thanasit në Dhërimi, në nderim e kujtim të Rilindjes sonë të parë kombëtare, të Shkollës së parë Shqipe, gramatikës e fjalorit të parë të shqipes dhe të historisë së lavdishme të ortodoksisë unite të Himarës. Gjithçka përfundoi në një plagjiaturë të shëmtuar e pavarlerë dhe në një trofe më shumë për ata që kërkonin të zhduknin simbolet dhe gjurmët e kësaj his-



torie. Nuk bëri ndonjë gjë ndryshe nga Berisha, i cili hapi për herë të parë një shkollë greke në Himarë dhe bashkëqeverisi me një grup ekstremistësh të korruptuar të Omonias, u hapi rrugë varrezave greke në Shqipëri dhe nënshkroi një marrëveshje skandalozë për ndarjen e detit. Zhurma që u ngrit, në fakt, shërbeu vetëm për të fshehur prishjet brutale pa legalizim, pa shpronësim dhe pa pagesë të shtëpive të banorëve të bregut.

Për t'u kthyer në krye të këtij shkrimi, prishja e befasishme e Shqiponjës, nuk ka lidhje me nevojën e Kryeministrit për të treguar se nuk është nacionalist, ai donte të fshihte abuzimin me pronat, shtëpitë, bizneset në Unazën e re, e cila është fatkeqësi për banorët dhe mundësi e artë për klientët e qeverisë. Kjo qeveri dhe kryeministri i saj i janë drejtuar maskarallëkut më të madh "nacionalizmit fasadë" sa herë që ua do puna të fshehin diçka të mbrapsh-

të. Kur nxirrte gravurat me harta të mesjetës dhe pamje të Akropolit të banuar nga shqiptarët, nga ana tjetër ishte duke biseduar me Kotzias për shitjen e hapësirës detare, fshirjen e emrit të Çamërisë, dhe falsifikimin e historisë që opinionit më vonë do t'ia shiste si kushte për integrimin e Shqipërisë në BE. Kur në këto pazare u përfshinë "nacionalistët" më zhurmëmëdhenj matanë kufirit dhe Kotzias u dorëzua, këto marrëveshje dolën në diell. Dolën në dritë edhe fondet sekrete greke për kishën autoqefale të Shqipërisë dhe për të blerë politikanët, gazetarët dhe intelektualët që tradhëtonin interesat e Shqipërisë dhe favorizojnë ato të Greqisë. Ja pse u bë kurban Kacifas dhe u gatua incidenti i Bularatit nga të dy qeveritë shqiptare e greke, që populli shqiptar mos të merrej me marrëveshjen e varrezave greke, imponimin e 28 tetorit si festë kombëtare të Shqipërisë dhe kapitujt e tjerë të marrëveshjes që

Rama e Bushati kishin bërë në fshehtësi. Shërri i stisur me Presidencën, për emërimin e ministrit të brendshëm ka për qëllim të sfuzojë jehonën negative që la në opinion menaxhimi i incidentit të Bularatit.

Më tej, për të mos prekur Vangjelët e parlamentit shqiptar, që u sollën si ushtarë të "Agimit të Artë", u shpall non grata një eurodeputete, Eleni Theocarous. Partia Zgjidhja kërkon që të zbatohet Kushtetuta dhe parlamentit të kërkojë llogari nga anëtarët e tij që shkelën ligjet e vendit me pjesëmarrjen e tyre në mitingje shoviniste dhe manifestime antishqiptare. Me këta politikanë që kemi na presin provokime e rreziqe të mëdha. Kushtetuta nuk mbrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese (që PS-PD, bashkërisht e kanë neutralizuar). Kuvendi ka rolin e tij. Ai duhet të mbrojë sovranitetin e vendit nga shovinistët dhe nga qeveritarët që bëjnë pazar me atdheut.

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të kaloni momente të këndshme nën shoqërinë e partneres në mbrëmje. Në punë do të keni pak ngarkesë. Besojini intuitës dhe ndiqni ëndrrat tuaja. Mos u ndikoni nga gjykimi i të tjerëve.

### DEMI

Do të keni pranë njerëz të këndshëm dhe që do ju kuptojnë. Mbrëmja do t'ju rezervojë një surprizë. Diçka që nuk e kishit parashikuar do t'ju ndodhë gjatë pasdites, që do ju bëjë të ndiheni special.

### BINJAKET

Parashikohet një ditë pa shqetësime. Aspekti planetar ju bën që të ndiheni të relaksuar. Sot është dita më e mirë për të treguar talentin tuaj të fshehur. Mos u kufizoni, por jepni 100 përqindësin tuaj.

### GAFORJA

Keni nevojë që të bëni disa ndryshime në jetën tuaj, veçanërisht në dashuri. Nëse jeni në një marrëdhënie romantike duhet të rishikoni prioritetet tuaja. Partneri ndoshta nuk ju kushton shumë vëmendje.

### LUANI

Ditë e mbarë për të nisur një lidhje të re dashurie. Energjia pozitive që ju karakterizon do të reflektohet edhe në pamjen tuaj. Në punë do të keni më shumë ngarkesë, por falë aftësive tuaja, do t'i kaloni me lehtësi.

### VIRGJERESHA

Do të jetë një ditë me ulje-ngritje në aspektin romantik. Keni nevojë për qëndrueshmëri në marrëdhënien tuaj, por kjo që do të jetë e vështirë të ndodhë. Nëkujtesë që tjetër veçse të mirëprisni fatin tuaj.

### PESHORJA

Duket se ditën e sotme do ju mungojë stabiliteti në punë për shkak të mungesës së përqendrimit. Diçka që ka të bëjë me fushën e ndjenjave ju shqetëson dhe ju shton nivelin e ankthit.

### AKREPI

Jeni i pavarësuar në lidhje me punën tuaj. Edhe pse nuk ju mungon ambicia për të pasur më shumë sukses, duket se ju mungon dëshira për të qëndruar në të njëjtën pozicion. Në rast se doni ndryshime, dita do të jetë me fat në këtë fushë.

### SHIGJETARI

Kini durim që të mund të punoni me qetësi. Një projekt mund të mos ju ecë mirë. Duke nxitur optimizmin është mënyra më e mirë për të përballuar me qetësinë e nevojshme vështirësitë që mund të lindin në stafin e punës.

### BRICJAPI

Duket se i keni marrë gjërat pak me nxitim në dashuri. Mundohuni që t'i hidhni hapat në mënyrë graduale, përndryshe mund të përfundoni duke bërë figurë jo fort pozitive. Me financat nuk i keni punët shumë mirë.

### UJORI

Nëse po planifikoni që të bëni një investim, apo të ndryshoni vendin e punës, këshilloheni që të prisni pak. Nuk është dita e duhur për projekte të mëdha. Prisni derisa energjia të jetë pozitive rreth jush.

### PESHQIT

Parashikohet të jetë një ditë me ngarkesa emocionale. Përpikuni të mos e lëshoni veten edhe kur përballeni me pengesa artificiale. Shumë shpejt do të kuptoni se nuk ia vlen të shqetësoheni për asgjë.

**Skocia humbet një lojtar**

**Dëmtohet Rajan Xhek, MekLish:  
Është një situatë e pafat**

Kristian Panuçi fërkon duart para ndeshjes kundër Skocisë dhe me të drejtë, pasi kundërshtarët e të shtunës, janë përgjysmuar nga dëmtimet e njëpasnjëshme, aq sa kanë filluar të tërhiqen edhe lojtarët që ishin thirrur si rezervë në ditët e fun-

dit. Dje, Skocia ka konfirmuar se një tjetër lojtar ofensiv, Rajan Xhek, është tërhequr për shkak të problemeve që ka pësuar në fundjavë. Futbollisti i Rejnxshtës u dëmtua në ndeshjen ku Eros Grezda

shkroi emrin mes protagonistëve në kampionatin skocez, në fitoren 7-1 kundër Madhëruell, ku futbollisti shqiptar shënoi 3 gola e dha asist. Por në atë sfidë, partneri i tij në mesfushë, Rajan Xhek, pësoi

një dëmtim muskolor që nuk i mundëson të luajë si ndaj kuadrajnive, ashtu edhe ndaj Izraelit. "Rajan është jashtë për këto sfida", konfirmoi edhe trajneri MekLish. "Ai luajti të gjithë ndeshjen për Rejnxs-

htës, por fatkeqësisht është dëmtuar. Janë gjëra që ndodhin. Është situatë e pafat, pasi ai u kthye në skuadër dhe mund të na ofronte diçka edhe në pozicione të ndryshme", deklaroi trajneri, i cili për shkak të dëmtimeve të njëpasnjëshme, është i detyruar të improvizojë thuasë në të gjitha repartet.

Ia doli të neutralizojë Ikardin, e vlerëson shumë në aspektin psikologjik paraqitjen ndaj Interit

**Gjimshiti: Me tifozët me vete, e thyejmë Skocinë**

*Mbrojtësi ndjen mungesën e një lideri si Cana*



Jeton Selimi

Berat Gjimshti vjen në Kombëtare pas një momenti mjaft të mirë, teksa gjeti rrugën e rrjetës në sfidën e fundjavës ndaj Interit, duke marrë dhe vlerësimet maskimale të trajnerit Gasperini në fitoren 4-1 ndaj milanezëve. Si të mos mjaftonte paraqitja mjaft e mirë, shqiptari mposhti ziktalërit me kokë, duke i siguruar fitoren Atalantës. Gjimshti ishte i pranishëm në konferencën e djeshme për shtyp në prag të ndeshjes me Skocinë që do të zhvillohet ditën e shtunë ku u shpreh: "Nuk e di nëse është momenti më i mirë ky. Besoj është një moment i bukur personalisht. Unë gjithmonë vij këtu për të dhënë maksimumin. Nuk ka problem nëse kam shënuar gol apo jo", -thotë Gjimshti që më pas përpjet të gjejë gjërat që nuk shkojnë në ekipin kuqezi. "Me Izraelin e patëm në dorë lojën, bëmë një ndeshje të mirë, nuk e merituan humbjen. Te goli i



parë ishim të ngrirë, nuk e pritëm që do e godiste portieri. Bëmë gabim të gjithë. Ato gjera ndodhën, të mun-

dohemi të bëjmë më mirë. Për mua nuk është autogol ai ndaj Skocisë. Por nuk ka problem. Nuk e di nëse do

luaj me Skocinë. Nëse jam në fushë, provoj të jap më të mirën. Në fillim duhet të mbroj, pastaj nëse del rast për të shënuar akoma më mirë. Mendoj se është e vështirë t'i markosh të gjithë sulmuesit. Nuk është vetëm Ikardi, në Itali ka nivel të lartë. Është një vlerësim psikologjik dhe duhet të japësh maksimumin të mos lejosh për të shënuar gol". Flitet gjithnjë e më shpesh se në Kombëtare mungon një lider, ndërsa i fundit që e ka bërë me sukses këtë gjë, ka qenë Lorik Cana. "Mungesa e Lorik Canës? Ne duhet të shikojmë përpara, nuk duhet të shikojmë mbrapa. Futbolli ecën shpejt. Të gjithë duhet të japin kontribut që të jemi sa më të fortë dhe të bashkuar. Është si alternativë rreshtive

mi me 3 mbrojtës. Mendoj që kemi shumë lojtarë që kanë luajtur disa herë atë sistem në ekipet e tjera. Nuk besoj se do jetë problem. E vendos trajneri. Mbrojtja bëhet me gjithë ekipin, nuk mbrohet vetëm me mbrojtësit. Ato që bëmë ishin gabime personale. Ndaj Izraelit kemi bërë gabime më shumë personale. Na kushtoi". Në fund, Gjimshti jep edhe parashikimin e tij në lidhje me ndeshjen e Skocisë. "Besoj se me Skocinë do jetë një ndeshje e vështirë. Ata luajtën me mirë atje, ne kemi rastin që të tregojmë vlerat tona. Në fund do arrijmë atë që duam. Nëse luajmë si skuadër, e dimë që jemi të fortë. Tifozët? Mendoj që na kanë përkrahur gjatë gjithë kohës. Shpresoj që do të jenë në stadium, të na japin forcën e tifozit".

**MBROJTËSI VETERAN**

**Lila: Kombëtarja është në fazën ndërmittë brezave**

Mesfushori Andi Lila, ishte i pranishëm në konferencën për shtyp në prag të ndeshjes ndaj Skocisë që do të zhvillohet ditën e shtunë në stadiumin "Loro Boriçi". Futbollisti kavajas u shpreh optimist dhe beson se Kombëtarja do të kthehet te rezultatet pozitive. "Çdo ditë me Kombëtaren është e veçantë. Çdo ndeshje është e jashtëzakonshme. Duhet të marrim rezultat pozitiv për momentin dhe të ardhmen e ekipit. Shpresojmë të bëjmë një paraqitje të mirë si ndeshja ndaj Izraelit, por të kemi një rezultat më të mirë. Duhet të përmirësohemi sa më shumë, si në stërvitje dhe në ndeshje. Shpresoj që gjithmonë të jemi me rritje të larta. Çdo futbollist të tregojë kontingjentin dhe cilësitë e veta. Ekipi është në një fazë ndërmittë gjeneratash. Do kohën e vetë. Në fund, skuadra ka zhvilluar ndeshje shumë të mira. Ka munguar fati dhe rezultati. Jemi në rrugën e duhur. Të gjithë bashkë duhet të jemi për të arritur objektivin madhor", -u shpreh Lila.

**PRAG-SKOCIA**

**Stërvitja e parë, mungojnë Grezda dhe Lenjani**

Trajneri Panuçi ka zhvilluar dje seancën e parë stërvitore në kuadër të ndeshjes me Skocinë, që luhet ditën e shtunë. Ka disa mungesa për këtë ndeshje, siç janë Hysaj dhe Basha për kartonë, ndërsa Manaj është i dëmtuar, porë atyre që dihen më parë. Por në seancën e parë, të zhvilluar në resortin "Tropikal" në Durrës, kanë munguar Eros Grezda dhe Ermir Lenjani, por mësohet se ata kanë dëmtime të lehta dhe nuk rrezikojnë për ndeshjen me Skocinë. Të dy kanë luajtur në kampionat me skuadrat e tyre dhe nuk përbëjnë problem për trajnerin Panuçi. Seancën e parë si kuqezi e ka zhvilluar dje edhe Ardjan Ismajli, i cili grumbullohet për herë të parë me Shqipërinë.

**Niko Kovaç është me valixhe në dorë**

**Bajneri i Mynihut josh Zinedin Zidanin**



dojnë seriozisht largimin e Niko Kovaç, i cili nuk po arin të marrë maksimumin

nga skuadra. Për këtë arsye, kanë filluar të kërkojnë alternativa sa më cilësore dhe ndonëse presidenti Uli Hënes nuk është një fans i trajnerëve të huaj, ai ka kuptuar se i nevojitet një emër i madh për të drejtuar ekipin. Për këtë arsye, i është bërë një ofertë e parë Zidan për të marrë drejtimin e skuadrës, me negociatat që vazhdojnë pasi francezi ka miqësi me Karl Hainz Rumengen dhe ka komunikuar me të edhe më parë.


**Reagimi i tërbuar ndaj gjyqtarit**

**Federata ndëshkon me dy ndeshje pezullim Gonzalo Higuainin**

Ndeshja e fundit në kampionat ndaj Juventusit, nuk ka shkuar aspak mirë për Milanin, ku përveç humbjes 0-2 në fushë, edhe sulmuesi kryesor Gonzalo Higuain u ndëshkua me karton të kuq duke lënë skuadrën e tij me 10 futbollistë. Sikur të mos mjaftonte vetëm kartoni i kuq dhe mungesa në një takim mjaft të vështirë si ai ndaj Lacios, është edhe Federata ajo që ka dhënë dënim për argentinasiin. Ai është pezulluar me dy ndeshje, duke humbur në këtë mënyrë edhe ndeshjen ndaj Parmës. Shkak për këtë pezullim me dy takime, është bërë protesta e tepruar e argentinasiit gjatë momentit që gjyqtari i ka treguar kartonin e kuq. Protestat e tij, kanë vazhduar edhe në momentin që është larguar drejt fushës dhe toni i përdorur ndaj zyrtarëve të ndeshjes, e ka përshkallëzuar dënimin.



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL
1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufoet.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagnit.
19. Në krye të trupave.
20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorragji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilent
32. Janë nofka.
35. Një provë... inteligjence.
37. Mund të jenë me sahat.


- 38. Një pjesë e naivitetit.
40. Pak imagjinatë.
42. Pikat pa kufij
43. Fillojnë aksionin.
44. Kërkohej nga poetët.
47. Nota e diapazonit.
48. I prin kolonës.
51. Eshhtë filozofie moralit.
52. Ulet në dhomën e lartë.
VERTIKAL
1. Malet pa kufij.
2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
4. Inicialet e Altman.
5. Një sportist që arrin majat
6. Courier ish-kampion i tenisit.
7. Fillojnë testin.
8. Mund të jetë parabolike.
9. Bie me ballë.
10. Carnera, ish-kampion i ringut.
11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
12. I kanë rrënjët në tokë.
15. Eshhtë pushkë.
16. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
17. Takim Brezash Durrës.
21. Ishte lumi i Elizit
22. Eshhtë kardinal.
24. Mbyllin një krah.
28. Artikull anglez.
30. Mbyllin fushatat.
31. Partia pa ara.
32. Zola që shkroi Nana
33. Nganjëherë duhen vënë mbi.
34. Një fjalë kastile
36. Inicialet e Mann shkrimtar.
39. Maiden që këndonë.
41. Ai i shtatë eshtë kinemaja.
43. Fillojnë arsyetimin.
45. Eshhtë nënë e Tironës.
46. Eshhtë shahu i fundit.
48. Inicialet e Klee piktor.
49. Dy asa.
50. Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL:
1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiuje.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Inicilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshhtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një eshtë për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.

- 39. Mbyllin një tender.
41. Një pjesë analogjisë.
42. Mjeku pa ju.
43. Nisin nga kreu.
44. Një racë kombi.
46. Një rapper i famshëm.
49. Një pikë... vaj.
50. Në fund majtas.
51. Ndizen me një çelës.
53. Emri i Delon
54. Janë të dërguar specialë


- VERTIKAL
1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
2. Eshhtë për medaljen e parë.
3. Një Pop i Andy Warhol.
4. Sapo fillojnë.
6. Qendër në Kubë.
7. Eshhtë pluhuri si Dash.
8. Eshhtë e hollë dhe therëse.
9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshhtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshhtë qyteti i njëmbjeshë dritareve.
21. Eshhtë dukuria.
22. Eshhtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndesha e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon çmimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshhtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dyqan.
52. Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PERGJIGJET E FJALEKRYQIVE TE NUMRIT TE KALUAR
R E S F D E T I
M A M A M M E P K E L
A M I S I M O N I A B O
T O T R E T O R I K A
E N O K D O M A T E L
R M A R T I R E T T O
I A R A T O N E R R R
A N M O I L A R R O D
L E N T E V E A P L R
A R M A N I E A N D E
T E R R I T O R I A L E M
K L A S A S P A R T A K U
K A R R I E R A R T U
M E R C E N A R A R O
G J I T U N E S U M O
L E E T O P S U A R
F I A T M S E R O T A
R M R S A M O T E R O
O B E R O N M I A R T
N I N A M A T H A U
T I A S T I R O I D E U
I N T E R I M M K E N

SUDOK

4 8 9 5 2
1 3 8 4
2 6 1
3 9 6
9 2 6 7 1
5 2
6 4 7
2 6
5 9 1 3

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1 6 7 4 5 2 9 3 8
8 3 5 9 1 6 4 2 7
4 9 2 3 7 8 5 1 6
5 8 1 6 9 3 7 4 2
9 2 3 7 8 4 6 5 1
6 7 4 5 2 1 3 8 9
7 1 6 8 3 5 2 9 4
2 5 9 1 4 7 8 6 3
3 4 8 2 6 9 1 7 5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Birra eshtë prova se Perëndia na do dhe dëshiron që të jemi të lumtur.
-Ka vetëm tre miq besnikë, një grua e vjetër, një qen i vjetër dhe para në dorë.
-Ekspërincia eshtë një mësuese e dashur dhe vetëm budallenjtë mësojnë nga gjëra të tjera.
-Të zgjuarit nuk kanë nevojë për këshillat. Vetëm budallenjtë nuk duan t'i marrin.
-Trajgjedia e jetës eshtë se plakemi shpejt dhe bëhemi të urtë shumë vonë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

4 1 9 2 10 19 6 5 4 5 3 19
6 4 1 3 11 3 T R 18 U 14 P
13 4 5 2 4 3 2 4 5 3 3
7 2 9 5 4 6 5 4 5 3 18
13 5 11 6 4 5 10 3 5 3 14 4
19 3 2 16 1 4 2 3 2
7 4 6 14 5 2 1 11 5
8 11 1 6 11 14 4 2 18 11
3 2 10 3 2 11 6 18 4 4 2
18 8 4 5 7 6 14 6 3 5
15 2 3 2 11 2 11 6 5 10 5 3
5 3 2 14 2 3 7 2 3 5 3 6
B A S T E T P A P A
U R A T U R H P A
S A M M A R A I N I
T A M E R I K A N E T
P R O T E S T A N T E T
G J I G A N T I I R R
B E T O N E K B O A T
S A L I R A M A E
G O N T I T U L L A R
A R E S A O E N E
Z J A R Z O T I M E T
I A M E R E N G U E S

Thënie të mençura

- Miqhtë, ashtu si peshku, fillojnë t'u vijë erë pas tri ditëve.
-Bëjini sytë katër para martesë, dhe mbajini gjysmë mbyllur pas martesë.
-Nuk luajmë më sepse plakemi. Plakemi sepse nuk luajmë më.
-Gazetat duket se e kanë të pamundur të diskriminojnë mes një aksidenti me biçikletë dhe kolapsit të një qytetërimi.
-Kërcimi: Shprehja vertikale e një dëshire horizontale të legalizuar nga muzika.
-Sikur të gjithë ekonomistët në botë të ishin vënë njëri pas tjetrit, nuk do të arrinin asnjë konkluzion.

